

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5705
E martë, 19 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Sa të jem unë kryeministër taksa nuk hiqet



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

DIALOGU KOSOVË - SERBI PO RIKTHEHET NË BINARËT E DUHUR



Prof. Lisen BASHKURTI

KRASNIQI: KOSOVA KA ARSYE TË SHUMTA TA KUSHTËZOJË DIALOGUN ME SERBINË

SENATORËT AMERIKANË: KOSOVA, PARTNERE E RËNDËSISHME PËR SHBA-në

EKONOMI

VESELI NË FORUMIN E INVESTITORËVE GLOBALË PARAQET POTENCIALET QË OFRON KOSOVA

'ORGANICHERB', PREZANTUESE E PRODUKTEVE ORGANIKE TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË NË NUREMBERG

KULTURË

VIGANI I STUDIMEVE TË GJUHËS E TË HISTORISË KOMBËTARE

Hasan MUJAJ

'FITORJA DIPLOMATIKE', NJË LIBËR DRITËHEDHËS MBI DIPLOMACINË E UÇK-së

F. 16

Lulëzim ETEMAJ f

SPORT

FLAMURTARI 'KORITI' PRISHTINËN, FERONIKELI MERR POZITËN E PARË

F. 18

ANALISTËT PARASHIKOJNË PRISHJEN E KOALICIONIT DHE KRIJIMIN E NJË QEVERIE TË RE

Njohësit e proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi dhe Behxhet Shala, kanë vlerësuar se çështja e taksës ndaj produkteve të Serbisë mund ta prishë koalicionin qeverisës. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se pozicionet e ndryshme të kryeministrit Haradinaj dhe të kryeparlamentarit Veseli lidhur me taksën kanë vënë në pikëpyetje vazhdimin e koalicionit. Sipas tyre, pas prishjes së koalicionit mund të formohet qeveria e re, pjesë e së cilës mund të jenë edhe PSD-ja dhe LDK-ja. Maliqi e Shala kanë parashikuar se formacionit të ri politik mund t'i paraprijë marrëveshja për mbajtjen e zgjedhjeve në vjeshtë



FAQE 3

INTERVISTË ME DEPUTETIN E PARLAMENTIT TË ZVICRËS, CARLO SOMMARUGA




KOSOVA ËSHTË E RËNDËSISHME PËR ZVICRËN

Carlo Sommaruga, deputet i parlamentit të Zvicrës, ish-kryetar i Komisionit Parlamentar të Politikës së Jashtme, kandidat për Dhomën e Shteteve (Senatin), me rastin e 11-vjetorit të pavarësisë, flet për zhvillimet në Kosovë, imazhin e saj dhe traumat e luftës, të pagjeturit, ndryshimin e kufijve dhe Dick Martyn. E quan të

pabesueshëm dhe absurd faktin e izolimit të Kosovës. Në intervistën që është realizuar nga Naim Malaj, Sommaruga thotë se do të ndërhyjë pranë qeverisë federale që Zvicra ta marrë rolin e lideres për lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës. Ai ka treguar si u votua në Komisionin e Politikës së Jashtme për njohjen e Kosovës

FAQE 4-5



Akademik Qosja: Kosovës i duhet shteti i së drejtës

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Veseli: Mbështetja e Kroacisë, e rëndësishme për Kosovën

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka zhvilluar një takim me presidenten e Republikës së Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović.

Në këtë takim Veseli dhe Kitarović kanë diskutuar për raportet e shkëlqyeshme që Kosova dhe Kroacia kanë ndër-tuar ndër vite midis tyre. Ata kanë theksuar se ka mundësi të shtimit të tyre në fusha të

ndryshme të interesit reciprok, veçanërisht në atë ekonomiko-tregtar.

Takimi ndërmjet kryeparlamentarit Veseli dhe presidentes kroate është zhvilluar në margjina të Forumit Botëror të Investitorëve "World Business Angels Investment Forum" (WBAF), i cili po mbahet në Stamboll.


Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović, ka konfirmuar

mbështetjen e shtetit të saj për Kosovën edhe në të ardhmen, si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar, në funksion të ruajtjes së paqes në rajon dhe të avancimit të shteteve ballkanike në rrugëtimin euroatlantik. Ndërsa kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se mbështetja e Zagrebit zyrtar për Kosovën është e rëndësishme po aq sa deri tani.



Akademik Qosja: Kosovës i duhet shteti i së drejtës

PRISHTINË, 18 SHKURT - Akademik Rexhep Qosja ka vlerësuar se nga Rilindja Kombëtare, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ajo e Kosovës, janë dy ngjarjet më të mëdha historike të kombit shqiptar. Në një intervistë për "A2 CNN" ai ka thënë se pavarësia e Shqipërisë dhe e Kosovës është arritur falë tre faktorëve: mendjes, pasurisë dhe luftës. "Në historinë e re shqiptare që fillon me Rilindjen Kombëtare dhe zgjatë deri sot janë dy ngjarje të mëdha, ngjarjet më të mëdha të kësaj historie: shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 dhe shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Duhet të thuhet se për këto dy ngjarje të mëdha janë investuar shumë përpjekje, shumë fuqi. Janë investuar përpjekje me laps, përpjekje me mend. Janë investuar përpjekje me pasuri të atyre që kanë pasur, të shqiptarëve, këtu shumë më tepër të shqiptarëve në botën e jashtme, sidomos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe mandej është investuar përpjekje me luftë. Pra tre faktorë kanë ndikuar që të arrihet Pavarësia e Shqipërisë



dhe e Kosovës: mendja, pasuria dhe lufta", ka thënë Qosja. Akademik Qosja ka pyetur vetën dhe të tjerët se si funksionon sot Kosova. Në këtë kontekst, Qosja ka thënë se Kosova sot funksionon si shtet autokratik. "Por ne sot duhet ta shtrojmë pyetjen. Si funksionon ky shtet, shtet i quajtur demokratik sot? Unë them se ky shtet i Kosovës sot në masë të madhe funksionon si shtet autokratik. Institucionet e këtij shteti janë institucione në

pjesën më të madhe të kohës autokratike të shtetit partiak", është shprehur Qosja. Ai ka thënë kjo gjendje nuk ka ndodhur aksidentalisht. "Si ta them aksidentalisht, pak si më vështirë ndodhin punët në politikë dhe në ndërtimin e shtetit. Por kanë ndodhur në një mungesë të një kulture të vërtetë demokratike, por edhe kanë ndodhur për hir të interesave të ndryshme të atyre që e mbajnë pushtetin", ka deklaruar Qosja, duke shtuar se

gjyqësori, mediet e shëndetësia janë të kontrolluara dhe të shpërfillura nga bartësit e shtetit. Më tutje, akademik Qosja ka folur edhe për kulturën politike në institucione. Ai ka thënë se njerëzit që janë në pushtet dikur kanë qenë të varfër. "Duhet të thuhet me keqardhje se numri më i madh i këtyre që janë në pushtet sot, kanë marrë pushtetin, që kanë fituar pushtetin edhe në zgjedhje kanë ardhur në pushtet si të

varfër. Sot janë njerëz të cilët, duke qenë në pozita politike, janë pasuruar në mënyrë të jashtëzakonshme. Dhe të gjithë ata, sidomos ata të rendit të parë dhe të rendit të dytë, e përdorin pushtetin për nevojat e veta", ka theksuar akademik Qosja, duke shtuar se niveli i korrupsionit është duke e dëmtuar Kosovën në të gjitha fushat.

Në këtë intervistë, Qosja ka përmendur edhe familjarizim në institucione, duke thënë se kjo dukuri është e rrezikshme për vendin. Në këtë aspekt, ai ka ofruar edhe zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet Republika e Kosovës.

Qosja ka thënë se zgjidhja e të gjitha problemeve të Kosovës është brezi i ri i njerëzve të politikës. "Unë them se e para e të parave që do bërë në Kosovë, për të evituar një dëshpërim të përgjithshëm, për të evituar një rënie të shëndetit etik të popullit, për të evituar një gjendje që e quajmë rrezik për paqen sociale në Kosovë, do të duhej që, para së gjithash, Kosova të bëhet shtet i së drejtës. Në Kosovë është e përçmuar, nënçmuar, e drejta - drejtësia. Prandaj Kosovës i duhet shteti i së drejtës", është shprehur akademik Qosja.

Grupi i PD-së vendos djegien e mandateve

TIRANË, 18 SHKURT - Grupi parlamentar i Partisë Demokratike iu përgjigj të hënën unanimisht propozimit të kryetarit të partisë, Lulzim Basha, për djegien e mandateve të deputetëve. "Duke mbështetur plotësisht zgjidhjen politike të ofruar nga opozita e bashkuar të një qeverie transitorie, të gatshme për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm, që do të garantojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme

dhe zhbllokimin e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë dhe hapjes së negociatave me Bashkimin Evropian, përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të parakohshme parlamentare, vendosi unanimisht djegien e mandateve parlamentare të Partisë Demokratike në Kuvendin e dalë me votat e krimin dhe mafies në zgjedhjet e manipuluar të 25 qershorit

2017", njoftoi Basha në përfundim të mbledhjes. Në selinë e Partisë Demokratike shkoi më vonë dhe drejtuesja e Lëvizjes Socialiste për Integritet, Monika Kryemadhi, partia e së cilës ka grupin e dytë më të madh të opozitës. LSI ende nuk është shprehur se çfarë qëndrimi do të mbajë dhe nëse do t'i bashkohet ose jo vendimit ekstrem të marrë nga demokratët.



Analistët parashikojnë prishjen e koalicionit dhe krijimin e një qeverie të re

Njohësit e proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi dhe Behxhet Shala, kanë vlerësuar se çështja e taksës ndaj produkteve të Serbisë mund ta prishë koalicionin qeverisës. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se pozicionet e ndryshme të kryeministrit Haradinaj dhe kryeparlamentarit Veseli lidhur me taksën kanë vënë në pikëpyetje vazhdimin e koalicionit. Sipas tyre, pas prishjes së koalicionit mund të formohet qeveria e re, pjesë e së cilës mund të jenë edhe PSD-ja dhe LDK-ja. Maliqi dhe Shala kanë parashikuar se formacionit të ri politik mund t'i paraprijë marrëveshja për mbajtjen e zgjedhjeve në vjeshtë



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 SHKURT - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë të hënën se, pas zhvillimeve të fundit lidhur me taksën ndaj produkteve të Serbisë, nuk ka mbetur hapësirë për ta vazhduar më tutje rrugëtimin koalicioni qeverisës. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pjesa e qeverisë që është për pezullimin e taksës duhet t'i ndërmarrë masat për zhblokimin e situatës, çka nënkupton prishjen e koalicionit qeverisës dhe krijimin e një qeverie të re. Maliqi ka theksuar se këto rokada mund të ndodhin shpejt pasi Kosova nuk mund të bëhet shkaktare e vonësës së mëtutjeshme në vazhdimin e dialogut me Serbinë. Sipas tij, kjo duhet të ndodhë para fillimit të muajit mars. "Sa po shoh unë, kryeministrit Haradinaj iu dha shansi që për gati një muaj e gjysmë të zbutet dhe pajtohet me pezullimin e afatizuar të taksës (jo heqjen e saj, ajo do të kthehet me automatizëm nëse dialogu nuk përfundon me sukses), por tanimë nuk ka mbetur hapësirë manovruese dhe pjesa e qeverisë që është për pezullimin e taksës duhet t'i ndërmarrë masat për zhblokimin e situatës, çka nënkupton prishjen e koalicionit qeverisës dhe krijimin e një qeverie të re, ku në formacion do të jenë PDK-ja me Nismën dhe AKR-në si dhe PSD-në, gjithsesi edhe LDK-në. Sa i përket LDK-së, në qoftë se nuk do të hyjë në koalicion, mund të jetë opsion i përkrahjes me vota të koalicionit të ri qeverisës pa qenë pjesë e saj, por si solution i kushtëzuar me caktimin e datës së zgjedhjeve (me gjasë në vjeshtë të këtij viti) si dhe të

revizionit të sistemit zgjedhor. Këto rokada mund të ndodhin shpejt sepse Kosova nuk mund të bëhet shkaktare e vonësës së mëtutjeshme për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Me gjasë kjo duhet të ndodhë para fillimit të muajit mars", ka deklaruar Maliqi.

Ai ka thënë se çështja e taksës dhe kufiri për Haradinajn sikur nuk janë dy çështje, por ai i sheh të ndërlidhura praktikisht si dy anë të një çështjeje. Sipas Maliqit, bllokada e këtyre ditëve ngjan me bllokadën e madhe të ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi. Ai ka thënë se ndryshimin e bën deri-diku LDK-ja që edhe sot është në mes, një pjesë anon nga taksë e Haradinajt, tjetra nga 'korrigjimet' e presidentit dhe pezullimi i taksës për të mos i prishur raportet me ShBA-në dhe BE-në. "Presioni ndaj kryeministrit Ramush Haradinaj është i madh si nga ndërkombëtarët, po ashtu edhe nga partnerët e koalicionit, por kjo sikur e radikalizon edhe më shumë Haradinajn që të këmbëngulë për mospezullimin e taksës dhe, njëkohësisht, mosndryshimin me asnjë kusht të kufijve të Kosovës. Taksë dhe kufiri të Haradinaj sikur nuk janë dy çështje, por ai i sheh të ndërlidhura, praktikisht si dy anë të një çështjeje. Kjo nyje ose bllokadë e këtyre ditëve mua më ngjan me atë bllokadë të madhe të para disa vjetëve kur e tërë politika e Kosovës për gati tri vjet rresht ngeci pezull dhe e bllokuar shkaku i ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. Edhe atëherë protagonistin më këmbëngulës i kundërshtimit ka qenë Haradinaj, por si opozitar, kurse repartin operativ të bllokadës dhe pengimeve të

seancave të Kuvendit e kryente Lëvizja Vetëvendosje duke hedhur gaz lotsjellës. Është interesant se edhe në bllokadën aktuale rreshtimi i forcave protagoniste është i ngjashëm: në njërin anë sërish janë Haradinaj dhe Kurti, në tjetrën presidenti Thaçi dhe Kadri Veseli me aleatët e vegjël të koalicionit në pushtet. Ndryshimin e bën deri-diku Isa Mustafa me LDK-në që atë botë ishte për demarkacionin, por ia kishte frikën votës për ratifikim dhe mbeti e pavendosur sikur edhe sot që po është në mes, një pjesë e LDK-së anon kah taksë e Haradinajt, tjetra nga 'korrigjimet' e presidentit dhe pezullimi i taksës për të mos i prishur raportet me ShBA-në dhe BE-në", është shprehur Maliqi.

Edhe analisti tjetër politik, Behxhet Shala, ka thënë të hënën për gazetën "Epoka e re" se pozicionet e ndryshme të kryeministrit Haradinaj dhe kryeparlamentarit Veseli lidhur me taksën ndaj Serbisë kanë vënë në pikëpyetje vazhdimin e koalicionit qeverisës. Sipas tij, në qoftë se Veseli dhe Haradinaj nuk ulen për të gjetur një zgjidhje, atëherë nuk ka kuptim funksionimi i mëtutjeshëm i këtij koalicioni. "Deklarata e Kadri Veselit, se kjo qeveri nuk do të bjerë për shkak të taksës, por do të prishet për shkak të ruajtjes së miqësisë me ShBA-në, është vetëm lojë fjalësh sepse pikërisht miqësia me ShBA-në ka

ardhur në pikëpyetje për shkak të taksës. Përderisa kryeministri Haradinaj s' dëshiron të hiqet taksë, kurse kryeparlamentari Veseli propozon pezullim të saj, atëherë nuk ka mbetur hapësirë për vazhdim të bashkëpunimit në kuadër të koalicionit qeverisës. Tashmë është në pikëpyetje vazhdimi i këtij koalicioni. Nëse nuk arrihet një kompromis nuk ka hapësirë për të vazhduar koalicionin", ka deklaruar Shala, duke shtuar se është pak e besueshme që kryeministri Haradinaj do ta pezullojë taksën.

Ai ka thënë se më e rrugës do të ishte prishja e koalicionit qeverisës sesa heqja e taksës ndaj Serbisë. "Kemi dy pozicione krejtësisht të kundërta. Kemi Haradinajn që me asnjë kusht nuk dëshiron ta heqë taksën dhe kemi Veselin që është për pezullimin e taksës. Përderisa kemi këtë pozicion të dy liderëve kryesorë të koalicionit nuk e di se çfarë kuptimi ka të vazhdohet me këtë koalicion, sepse kanë mosmarrëveshje substanciale dhe të papajtueshme. Për bindjen time, në aspektin politik më mirë do të ishte që të bjerë ky koalicion sesa të hiqet taksë", është shprehur Shala, duke shtuar se kryeparlamentari Veseli e ka obligim moral e material që ta përkrahë kryeministrin Haradinaj meqë bashkë i kanë hyrë kësaj pune. "Kryeministri Haradinaj nuk duhet lënë vetëm përballë këtij presioni", ka thek-

suar ai. Sipas Shalës, më mirë do të ishte që vendi të shkojë në zgjedhje sesa spektri politik t'u dorëzohet presioneve ndërkombëtare për heqjen e taksës. "Në fund të fundit, nëse nuk ka asnjë rrugë tjetër, atëherë duhet të shkohet në zgjedhje. Zgjedhjet i konvenojnë Haradinajt nëse nuk e heq taksën, por nëse e heq taksën ai do të humbë politikisht", ka thënë ai.

Njohësi i proceseve politike, Behxhet Shala, ka vlerësuar se presioni ndërkombëtar nuk është duke u bërë për taksën, por për vazhdimin e dialogut dhe arritjen e marrëveshjes. Sipas tij, taksë është e vogël që të merret seriozisht BE-ja, ShBA-ja dhe NATO-ja. "Taksë është tepër e vogël për t'u marrë me ShBA-në, e sidomos pakti NATO. Por, kur të jesh i vogël dhe nuk ke përkrahje si dhe kur je i dobët, atëherë edhe prej gjërave më banale varet bashkëpunimi. Taksë nuk është arsyeja e vërtetë e këtij presioni, por vazhdimi i bisedimeve", ka theksuar ai, duke shtuar se e ashtuquajtura marrëveshje gjithëpërfshirëse Kosovën e fut në destabilizim afatgjatë.

Shala ka vlerësuar se letra e Trumpit është e dëmshme për Kosovën. "Nëse analizohet përmbajtja dhe qëllimi i saj, unë mendoj se është arritja e një marrëveshje të shpejtë", është shprehur Shala, duke shtuar se zgjidhja në mes të dy vendeve duhet të ndodhë brenda kufijve ekzistues.

Intervistë me deputetin e parlamentit të Zvicrës, Carlo Sommaruga

Kosova është e rëndës

Carlo Sommaruga, deputet i parlamentit të Zvicrës, ish-kryetar i Komisionit Parlamentar të Politikës së Jashtme, kandidat për Dhomën e Shteteve (Senatin), me rastin e 11-vjetorit të pavarësisë, flet për zhvillimet në Kosovë, imazhin e saj dhe traumat e luftës, të pagjeturit, ndryshimin e kufijve dhe Dick Martyn. E quan të pabesueshëm dhe absurd faktin e izolimit të Kosovës. Në intervistën që është realizuar nga Naim Malaj, Sommaruga thotë se do të ndërhyjë pranë qeverisë federale që Zvicra ta marrë rolin e lideres për lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës. Ai ka treguar si u votua në Komisionin e Politikës së Jashtme për njohjen e Kosovës. Gjithashtu, flet edhe për diasporën shqiptare në Zvicër, islamin laik shqiptar, "shqiponjën e Shaqirit dhe Xhakës", për peizazhet e bukura të Kosovës dhe plazhet shqiptare

Intervistoi: Naim MALAJ

Kosova po feston 11-vjetorin e pavarësisë. Cili është vështrimi juaj për këtë rrugëtim 11 vjeçar të këtij shteti më të ri në botë?

Carlo Sommaruga: Gjatë qëndrimit tim në Kosovë, në gusht 2018, kam zbuluar një realitet politik social dhe historik, një imazh të Kosovës ndryshe nga ai që e kisha më parë dhe që, me gjasë, e ka një pjesë e klasës politike zvicerane. Për shumicën e politikanëve zviceranë, problemi i luftës me Serbinë është një kapitull i mbyllur. Kanë mbetur për t'u zgjidhur me Serbinë vetëm disa çështje teknike rreth kufirit. Ndërsa problemi më i madh shihet ai i luftës ndaj korrupsionit. Kjo vizitë në Kosovë më ka ndërgjegjësuar për tragjedinë e luftës, plagët e hapura, sidomos personat e pagjetur, familjet e të cilëve janë në kërkim të fëmijëve, baballarëve ose të kushërinjve. Kam kuptuar se shumë gra kanë përjetuar në trupin e tyre traumatizmat e luftës. Kosova është një vend i ri, por që ka përpara një punë të madhe, një proces të gjatë të zgjidhjes së traumatizmave të luftës.

Kam qenë i prekur, po ashtu, nga dinamika dhe vullneti i burrave dhe grave për të ndërtuar një të ardhme pozitive të Kosovës, por kam parë ose kam kuptuar gjithashtu më mirë, rolin e diasporës. Një rol shumë i madh për mbështetjen e familjeve dhe të vendit. Është e vërtetë se gjatës verës tabelat zvicerane të makinave janë të shumta. E kuptojmë se diaspora e Kosovës në Zvicër luan rol shumë të rëndësishëm për shoqërinë dhe vendin. Gjatë qëndrimit tim kam zbuluar peizazhe dhe një vend që deri më tani nuk e kam njohur dhe mendoj se me një dinamizëm mund të tërhiqni një turizëm nga Zvicra dhe Evropa për të zbuluar peizazhe të paprekura dhe male të cilat zviceranët i pëlqejnë shumë.

Pra, ka një dinamikë të shoqërisë për të ecur përpara, por ka edhe një lodhje të qytetarëve të Kosovës ndaj autoriteteve. Duket sikur klasa politike ishte e paafte për t'iu përgjigjur aspiratave të popullit dhe e angazhuar më shumë në një luftë për pushtet sesa për një emancipim të shoqërisë. Për këtë më vjen shumë keq. Mendoj se kjo mund të ndryshojë me një pjesëmarrje më të madhe të shoqërisë civile. Pra, burrat dhe gratë e Kosovës do të duhej të investonin në shoqërinë civile, mos të jenë të varur nga vendimet politike, por që propozimet e tyre të vijnë jashtë partive politike.

Në Kosovë ka pasur zgjedhje të lira, të njohura dhe të pranuar nga të gjithë pa ndonjë kontestim siç ndodh në disa vende të regjionit. Institucionet e saj kanë treguar stabilitet politik. Përkundër kësaj, Kosova nuk shquhet për një imazh të mirë. Kosovarët janë qytetarët e vetëm në Evropë që nuk kanë të drejtë të udhëtojnë pa viza. Mendoni se ka një punë për të bërë nga ana e autoriteteve kosovare, por edhe të diasporës, për përmirësimin e imazhit të saj?

Carlo Sommaruga: Gjatë udhëtimit tim kam parë ndërmarrje ekonomike të vogla dhe të mesme që janë aktive në fusha të ndryshme të cilat punojnë për tregun evropian dhe zviceran. Ndërsa gjëja më e pabesueshme është se Kosova është e izoluar për shkak të vizave. Për t'i transportuar mallrat e Kosovës të destinuar për tregun evropian duhet kaluar përmes kompanive transportues maqedonase. Kjo flet për absurditetin e situatës. I vëmë pengesa Kosovës, ndërkohë që e ardhmja e saj kalon përmes zhvillimit ekonomik. Është e qartë se duhet lehtësuar qasjen në tregun zviceran ose evropian dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve. Në këtë drejtim do të ndërhyj pranë qeverisë federale dhe parlamentit duke kërkuar që Zvicra ta marrë rolin e lideres për



liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Në Kosovë, një vend i vogël, ne kemi konsullatën më të madhe në botë. Njerëzit kanë nevojë të lëvizin për arsye familjare, tregtare etj. ndërsa ne u vendosim pengesa. Kjo gjendje është absurde nga këndvështrimi zviceran dhe ai kosovar. Unë përshëndes faktin që tani e tutje zviceranët mund të udhëtojnë drejt Kosovës me letërnjoftim. Duket gjë e vogël, por ne e vlerësojmë.

Rreth çështjes së imazhit...

Carlo Sommaruga: Rreth perceptimit të Kosovës në Zvicër mendoj se shumica e njerëzve besojnë se kosovarët janë njerëz seriozë dhe punëtorë, të cilëve mund t'u besojmë. Në tregun e punës kjo gjë nuk kontestohet. Në klasën politike në Zvicër, ku nacionalistët janë shumë të pranishëm (natyrisht kjo vlen edhe për komunitetet e tjera) ata cilësohen si dele të zeza. Është e vërtetë se në çaste të kaluara ka pasur një kriminalitet ndërkombëtar në Zvicër që kalonte përmes Kosovës dhe kjo ka lënë gjurmë më të thella në Zvicrën gjermane sesa në atë

romande. Këtu jam i bindur se ka nevojë që autoritetet dhe përfaqësitë diplomatike e konsullore të Kosovës në Zvicër ta forcojnë shkëmbimin me autoritetet kantonale, por edhe ato federale dhe, ndoshta, më shumë me anëtarët e komisionit për politikë të jashtme. Jo vetëm që të forcohet shkëmbimi, por të ketë një program në fushën kulturore, dmth. ekspozita, shfaqje teatrale, muzikore etj. Kjo do ta mundësonte njohjen reciproke dhe do t'i nxiste qytetarët zviceranë për ta vizituar Kosovën dhe zbuluar historinë e popullit shqiptar dhe historinë më të re të Kosovës

E keni lexuar artikullin e javores "Die Weltwoche" e cila i fyen kosovarët?

Carlo Sommaruga: E kam lexuar. Është një artikull skandaloz. I mbushur me urrejtje për popullin e Kosovës. Gjatë historisë me artikuj të tillë kemi rrëshqitur drejt nënçmimit të një populli, pastaj drejt dehumanizimit komplet dhe, në fund, drejt gjenocidit. Kjo duhet denoncuar në mënyrë të vendosur.

Megjithatë, kosovarët janë

integruar mirë, sporti është një shembull i mirë.

Carlo Sommaruga: Në përgjithësi, integrimi përmes sportit, nëse ai paraqitet si një etapë e parë e integritit të një komuniteti, është gjë pozitive. Por, nëse sporti është mjeti i vetëm i një integrimi social, atëherë kjo do të shihej si një dështim i politikës integruese. Para 30-40 vjetësh në Zvicër kishim futbollistë me origjinë italiane që luanin për kombëtaren tonë. Sot nuk ka gati asnjë futbollist të tillë, sepse tani ata i gjejnë në ekzekutivet dhe parlamentet e qyteteve apo të kantoneve. Në Gjenevë nga shtatë anëtarë që ka qeveria kanonale, dy janë me origjinë italiane. E në kuadër të qeverisë federale një ministër nga shtatë, është me origjinë italiane. I njëjti fenomen paraqitet te spanjollët të cilët janë të pranishëm në ekzekutive.

Dmth., pas 30 vjetësh do të kemi këshilltarë (ministra) në qeverinë federale me origjinë nga Kosova?
Carlo Sommaruga: Mund të them se sot kemi këshilltarë komunalë nga Kosova, ndërsa në

sishme për Zvicrën



parlamentin e Gjenevës është një deputete (Xhevrje Osmani) me origjinë nga Kosova. Pra, shihet që Zvicra, përkundër një konteksti të vështirë, mund t'i integrojë njerëzit. Presidenti i qeverisë kantonale në Gjenevë është refugjat nga Argjentina, ndërsa në parlamentin e Zvicrës është një deputete grua me origjinë kurde. Shpresoj që në rastin e komunitetit kosovar kjo do të realizohet më shpejt. Jam i bindur se komuniteti kosovar, duke e ditur numrin e madh në Zvicër, do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve mes popullatës zvicerane dhe komunitetit mysliman. Kosovaret janë myslimanë laikë, me një besim dhe praktikë fetare të qetë dhe mendoj se ata kanë për të luajtur një rol thelbësor në ndryshimin e mentaliteteve në Zvicër sikur në rastin e nënshkrimit të deklaratës së laicitetit nga dy shoqatat e myslimanëve shqiptarë në Zvicër.

Dy të rinj nga Kosova shtrinë për tokë kombëtare në Serbisë në ndeshjen me Zvicrën.

Carlo Sommaruga: Rreth të famshmes shqiponjës dykrenare,

reagimi i zviceranëve ishte shumë pozitiv. Përtej këtij simboli historik dhe politik të shprehur nga Shaqiri dhe Xhaka, mendoj se, për ata dhe bashkësinë shqiptare në Zvicër, ka qenë një revansh lirie nga dominimi politik e kulturor serb dhe një mënyrë për t'u shprehur lirshëm edhe në fushën e futbollit. Dhe e gjithë kjo është bërë në një dinamikë pozitive të kombëtares së Zvicrës, që ka mundësuar të ketë një rezonancë shumë pozitive në gjirin e popullatës zvicerane e cila e ka kuptuar që plagët në mes të Kosovës dhe Serbisë janë ende të freskëta. Por, duhet theksuar, pavarësisht gjestit, diaspora e Kosovës kërkonte vetëm një gjë: suksesin e kombëtares zvicerane.

Zvicra është një ndër vendet e para që e ka mbështetur dhe njohur pavarësinë e Kosovës. Para këtij vendimi të qeverisë pati një votim në Komisionin e Politikës së Jashtme. Si rrodhi ky votim.

Carlo Sommaruga: Kam qenë në Komisionin e Politikës së Jashtme kur është bërë ky votim. Duhet thënë se socialistët në përgjithësi, si Micheline Calmy Rey, kanë

luajtur rol aktiv në njohjen e Kosovës nga Zvicra. Njohja ishte një akt politik shumë i rëndësishëm pasi kontribuonte në qetësimin e gjendjes në rajon. Më kujtohet që në komision e kishim ndërprerë votimin pasi kishte ende deputetë që hezitonin ndaj nuk dëshironim të kishim një votë negative. Por, në fund, çdo gjë shkoi mirë. Duhet thënë se nacionalistët e partisë UDC/SVP në Zvicër e kanë kritikuar dhe janë përpjekur ta bëjnë instrumentalizimin e kësaj vote duke njollosur imazhin e kosovarëve në Zvicër, imazhin e Kosovës dhe të përgjegjësve të saj politikë. Por, pa sukses.

Kosova vazhdon të mbetet e rëndësishme për politikën e jashtme të Zvicrës?

Carlo Sommaruga: Diaspora e Kosovës përbën një rëndësi të madhe në proporcion me popullatën e Kosovës, ngaqë më shumë se 10 për qind e saj jeton në Zvicër. Dërgimi i remitancave është i rëndësishëm edhe për Zvicrën. Kosova është e rëndësishme për Zvicrën sepse një destabilizim i saj do të sillte valë të reja refugjatësh tek ne, por edhe tensione në diasporë. Këto tensione mund të shpreheshin përmes dhunës dhe kjo nuk do të ishte në interes të dy vendeve. Po, Kosova është e rëndësishme për Zvicrën.

Jam shumë i kënaqur për kontributin e Zvicrës përmes Swisscoy për stabilizimin e gjendjes politike dhe të sigurisë në Kosovë. Fakti që Zvicra nuk ka tërhequr ende Swisscoy nga Kosova është një tregues i vullnetit tonë për të marrë pjesë në procesin e sigurisë dhe të stabilizimit të gjendjes në vend.

Kohët e fundit, në kuadër të arritjes së një marrëveshje finale me Serbinë, është hedhur edhe ideja e shkëmbimit të territoreve? Cili është mendimi juaj?

Carlo Sommaruga: Ajo që konstatoj është se procesi i normalizimit të marrëdhënieve politike mes dy vendeve që kanë përjetuar tensione politike dhe luftë është i gjatë dhe i komplikuar. Procesi politik i arritur në mes të Greqisë dhe Maqedonisë rreth emrit tregon se dialogu mund të ketë sukses dhe pse kjo ishte një çështje shumë e ndjeshme. E kemi parë këtë nga mobilizimi i njerëzve në rrugë në dy vendet. Përhëndes angazhimin e dy kryetarëve dhe dy kryeministrave të cilët janë angazhuar deri në fund dhe kanë fituar betejën politike. Ndoshta do ta humbin pushtetin më vonë, por ata u kanë bërë shërbim vendeve të tyre, stabilitetit të Ballkanit dhe të Evropës në përgjithësi. Kjo do të duhej ta

inspironte Kosovën dhe Serbinë në dialog i cili do të duhej të ishte i barabartë dhe jo i imponuar.

Cila është zgjidhja? A është ndryshimi i vijës kufitare zgjidhja? Është gjithmonë vështirë të modifikosh një vijë kufitare për arsye etnike. Por nëse procesi bëhet në respekt të zgjidhjeve demokratike të një vendi duke respektuar të drejtën ndërkom-bëtare, sipas mendimit tim, ky proces duhet të arrihet. Natyrisht që kjo është një çështje që i takon Kosovës dhe Serbisë. Por duhet të kthehet parasysh që në mozaikun e ish-Jugosllavisë kjo mund të shkaktoje procese të tjera të ngjashme ose të ngjallte dëshira për rivizatimin e disa kufijve. Kjo është një komponentë që dy vendet duhet ta kenë parasysh. Do të dëshiroja që në tavolinën e bisedimeve të kishte diplomatë zviceranë jo për të gjetur një zgjidhje, por për të reflektuar rreth respektit të pakicave dhe procesit demokratik pasi ne kemi një përvojë të gjatë demokratike të votës popullore si dhe të ndryshimit të kufijve takorë me shumë pasione. E dimë edhe në Zvicër që është një proces shumë i gjatë, por është e rëndësishme që procesi të jetë demokratik. Edhe pse edhe në Zvicër nganjëherë proceset demokratike ankimohen në gjykata.

Ju e njihni senatorin Dick Marty. Cili është mendimi juaj për raportin e njohur të tij për të ashtuquajturin trafik organesh, raport që ka shërbyer si bazë për themelimin e Gjykatës Speciale të Hagës?

Carlo Sommaruga: Dick Marty është një personalitet që gëzon respekt të madh në Zvicër. Ai gjithmonë ka qenë i pavarur dhe ka pasur një sjellje të një etike të lartë. Falë tij janë zbuluar burgjet sekrete të CIA-s në Evropë. Ai ka denoncuar pengmarrjet ilegale të bëra nga CIA në Itali dhe gjetiu në Evropë. Për Zvicrën është vështirë të mendohet që analiza e tij rreth Kosovës ka dashur të mashtrojë dikë ose t'i njollosë personalitetet politike të Kosovës në pushtet. Por, unë nuk e përjashtoj mundësinë që informacionet me të cilat ai dispononte të jenë jokomplete dhe të orientuara. Mbase analiza e tij në këtë drejtim nuk është e duhur dhe, ndoshta, ka arritur në konkluzione që nuk janë korrekte. Personalisht, nuk mund të shprehem rreth kësaj çështje, por mendoj se autoritetet e Kosovës duhet të bashkëpunojnë me të dhe autoritetet e tjera.

Rreth bashkëpunimit të Kosovës, Gjykata Speciale është themeluar me votën e Kuvendit të Kosovës dhe, nëse ka një vend në rajon që ka bashkëpunuar me drejtësinë

ndërkombëtare, ai është Kosova.

Carlo Sommaruga: Ky aspekt i bashkëpunimit nuk vihet në dyshim. Më duket i nevojshëm një proces që riverifikon faktet në një distance kohore pavarësisht prej vështirësive për provat, por që bën të kemi një shikim më të shkëputur në kohë: dëshiroj që ky proces të sjellë qetësi në Kosovë si dhe në marrëdhëniet me instancat e drejtësisë ndërkom-bëtare dhe BE-së.

Shqipëria është një vend tjetër i shqiptarëve. Ju e keni vizituar atë disa herë. Me çfarë përshtypje jeni ndarë?

Carlo Sommaruga: Gjatë udhëtimit të fundit në Shqipëri kam vërejtur gjëra që nuk i kisha parë gjatë dy vizitave të mia zyrtare në këtë vend. Gjatë kontakteve me njerëz kam konstatuar se ka një hapësirë shqiptare që përbën Kosovën, një pjesë të mirë të Maqedonisë dhe Shqipërisë. Kufijtë nuk kanë kuptim për shumë njerëz pasi ata kanë familje gjithandej. Ata shkojnë në pushime nga Kosova në Shqipëri ose vizitojnë anëtarë të familjes në Maqedoni. Kjo më ka befasuar shumë dhe më bën të mendoj se Zvicra duhet ta vazhdojë dinamikën e përafrimit të Shqipërisë e cila për arsye historike është e harruara e Evropës.

Shqipëria ka një përparësi që nuk e ka Kosova, plazhet. Kjo është tërheqëse për turistët evropianë, e sidomos të tyre nordikë, në kërkim të ngrohtësisë diellore. Kam parë shumë kosovarë, edhe zviceranë, që shkojnë për pushime në plazhet e Shqipërisë. Shpresoj se linja e re ajrore Zurich - Tiranë do ta shtojë numrin e turistëve zviceranë në Shqipëri. Ka një potencial për një zhvillim ekonomik dhe mendoj se duhet ndihmuar Shqipërinë. Një Shqipëri e zhvilluar ekonomikisht do të ishte në interes të Kosovës.

Në fund një mesazh për diasporën e Kosovës në Zvicër?

Carlo Sommaruga: Një pjesë e mirë e kosovarëve janë dyshtetas. Unë jam italo-zviceran. Kjo është historia moderne e emigracionit në Zvicër. Dyshtetësit janë shans i madh, sepse këta njerëz mund të kontribuojnë për ndërtimin e vendeve të origjinës dhe të atyre mikpritëse. Pjesëmarrja e këtyre njerëzve në votimet në Zvicër është shumë e rëndësishme, sidomos kur mendohet për iniciativat e partisë UDC/SVP për kufizim të emigracionit dhe mbylljes së kufijve, por edhe gjatë zgjedhjeve në Zvicër, për t'i mbështetur ato forca dhe personalitete politike që angazhohen për një Zvicër më të hapur dhe më mikpritëse dhe të angazhuar ndaj Kosovës.

Senatorët amerikanë vizitojnë Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK)

Senatorët amerikanë: Kosova, partnere e rëndësishme për ShBA-në

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, i ka njoftuar senatorët amerikanë me detyrat dhe planet që e presin FSK-në me mision të ri, atë ushtarak, në ngritjen e strukturës dhe kapaciteteve operacionale. Senatori James Inhofe ka pohuar se Kosova është një partnere e rëndësishme për Shtetet e Bashkuara dhe për NATO-n

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 SHKURT - Një delegacion i senatorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) që po qëndron në Kosovë ka vizituar Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku është pritur nga komandanti i saj, gjeneralletenant Rrahman Rama. Delegacioni i kryesuar nga senatori James M. Inhofe, kryesues i Komitetit të Senatit për Shërbimet

e Armatosura, shoqërohej edhe nga senatorët: Michel B. Enzi, John N. Boozman, Marion Round dhe përfaqësuesit Trent Kelly dhe Gregory Gianforte.

Në takim komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama i njoftoi senatorët, për aktivitetet e zhvilluara në kuadër të partneritetit me ShBA-në, rëndësinë që ka për FSK-në ky partneritet, në veçanti për Programin e Partneritetit Shtetëror me Iowan,

bashkëpunimin me Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NALT) që është i atashuar në Ministri dhe Forcë si dhe bashkëpunimin e mirë me KFOR-in.

Po ashtu, gjeneral Rama i njoftoi mysafirët e lartë nga ShBA-ja edhe me detyrat dhe planet që e presin FSK-në me mision të ri, atë ushtarak, për ngritjen e strukturës dhe kapaciteteve operacionale, duke bashkëpunuar ngushtë me

ShBA-në, me partnerët e tjerë strategjikë, NATO-n dhe vendet aleate.

Kryesuesi i delegacionit të senatorëve nga ShBA-ja, senatori James M. Inhofe, ndër të tjera, u shpreh se është i nderuar ta udhëheqë delegacionin nga Kongresi Amerikan në Kosovë. "Kosova është një partnere e rëndësishme për Shtetet e Bashkuara dhe për NATO-n, pasi punojmë së bashku për ndalimin e rritjes së agresionit rus në rajon", ka thënë ai.

Në takim ishin të pranishëm edhe gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, gjeneralbrigade Enver Cikaqi dhe kolonel Jeton Dreshaj.

Senatorët amerikanë janë takuar edhe me presidentin Hashim Thaçi, i cili ka thënë se ishte i nderuar t'i presë në takim sena-

torët amerikanë të udhëhequr nga senatori Jim Inhofe. "Kjo vizitë është dëshmia më e mirë e marrëdhënieve tona të shenjta. Kosova, gjatë tërë rrugëtimit të saj, e ka pasur përkrahjen e rezervë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka thënë Thaçi.

Po ashtu, ky delegacion amerikan është takuar edhe me kryeministrin Ramush Haradinaj. "Shumë i nderuar ta prisja delegacionin e senatorëve dhe kongresistëve amerikanë, prirë nga senatori James Inhofe. Inkurajim i fuqishëm që të qëndrojmë në vlerat tona të përbashkëta dhe për ta avancuar pozitën e gjithanshme të Kosovës. Dashuria dhe besnikëria e Kosovës ndaj Amerikës është e përhershme. Zoti e bekoftë miqësinë tonë!", ka thënë Haradinaj pas takimit.



Krasniqi: Kosova ka arsye të shumta ta kushtëzojë dialogun me Serbinë

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, është shprehur kundër heqjes së taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe. Madje, sipas tij, kjo taksë është e vonuar dhe se në drejtim të politikës agresive të Serbisë, Kosova duhet të vendosë masa të tjera si dhe ta kushtëzojë dialogun. Krasniqi është shprehur edhe

kundër idesë së korrigjimit të kufijve me Serbinë, duke thënë se Kosova nuk ka çfarë t'i japë Serbisë.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës ka këmbëngulur se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të udhëhiqet nga delegacioni shtetëror i votuar në Kuvend dhe jo nga presidenti Hashim Thaçi.

Krasniqi në një intervistë për

"Kosovapress" e ka këshilluar kryeministrin Ramush Haradinaj që të qëndrojë pas taksës. "Mendoj se Kosova do të duhej të nxirrte edhe masa të tjera dhe, ndoshta, edhe ta kushtëzonte dialogun, por Kosova nuk e ka kushtëzuar dialogun. Dialogu duhet të vazhdojë për faktin se Kosova ka shumë arsye ta kushtëzojë dialogun", ka thënë Krasniqi.



Kryeministri Ramush Haradinaj ka mbrojtur sërish qëndrimin e vet për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë

Haradinaj: Sa të jem unë kryeministër taksa nuk hiqet



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se për aq kohë sa ai të jetë në postin e kryeministrit taksa ndaj produkteve të Serbisë nuk do të hiqet. Nga Kompleksi Memorial në Glllogjan, Haradinaj ka thënë të hënën se Kosova nuk do të bëjë hapa mbrapa në dialogun me Serbinë, duke e hapur çështjen e kufirit

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, edhe të hënën e ka bërë të qartë qëndrimin e vet rreth taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë. Gjatë vizitës në Kompleksin Memorial në Glllogjan, ku ka bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve, ai ka deklaruar se taksa nuk do të hiqet për aq kohë sa do të jetë në postin e kryeministrit. "Shpresoj më dëgjua shumë mirë. Po e shihni ku kam ardhur për ta thënë. Sa të jem unë kryetar qeverie taksa nuk hiqet", ka thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se nuk do të lejohet në asnjë mënyrë që të hapet çështja e kufijve Kosovë - Serbi. "Është gabim i madh dhe do të ishte e pafalshme që shqiptarët ta përsëritin historinë e gabuar për të hapur një të arritur. Pra, nuk bëjmë hapa mbrapa. Kur them nuk

bëjmë hapa mbrapa, them se ne nuk lejojmë hapjen dhe tjetërsimin e Kosovës së pavarësisë të 17 shkurtit. Një popull ndaj të cilit është ushtruar gjenocid dhe është përndjekur i gjithë populli, rreth 20 mijë gra të dhunuara e rreth 15 mijë të vdekur, u dashka të japë diçka për njohje?! Në fakt, e drejta politike e çdo norme do të ishte që njohja nga Serbia të vijë si kërkim-falje për atë që i ka shkaktuar Kosovës jo vetëm në luftën e fundit, por edhe në përpjekjet e mëhershme", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se tani bashkësia ndërkombëtare po kërkon që Kosova t'i japë diçka Serbisë në këmbim të njohjes. Sipas tij, kjo po ndodh për shkak se Kosova është udhëhequr shumë dobët deri më tani. Haradinaj ka treguar se Kosova në këmbim të njohjes mund ta japë vetëm tregun e saj. Ai ka hedhur poshtë pretendimin e presidentit serb, i cili, në Konferencën e

Munihut, ka theksuar se kufirin në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk e di askush. I pari i Qeverisë ka thënë se e gjithë bota e di kufirin ndërmjet dy shteteve, duke përfshirë edhe NATO-n e cila e ruan këtë kufi. "Njohje reciproke po, në kufijtë ekzistues po, jo me çmim të një Republika Serbe si e Didkut e cila është një mini Rusi. Pse po i flas këto? Për t'ia qartësuar herët dhe me kohë popullit të Kosovës dhe aleatëve tanë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se nëse tani Kosova lëviz nga pozicioni i saj, ekziston mundësi që në të ardhmen do t'i kërkohet edhe më shumë. "Nuk ka kthim mbrapa dhe taksa nuk hiqet deri në njohje. Nëse ne fillojmë të bëjmë hapa prapa, njëherë kërkohet të hiqet taksa, nesër mund ta kërkojnë të hiqet 'Trepça', të hiqet ushtria dhe të hiqet diçka tjetër. Pra, mënyra e kushtëzimit ndaj shqiptarëve nuk do të ketë kufij", ka thënë Haradinaj. Kreu i ekzekutivit ka folur edhe për raportet e koalicionit qeverisës, duke thënë se të gjithë kanë qenë të pajtimit që të vendoset taksa 100 për qind për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. "Kërkoj përkrahjen tuaj, edhe të partnerëve politikë, edhe pse mund të kemi mendime të ndryshme. Një gjë është e

vërtetë, kur e kemi marrë vendimin për taksën kemi qenë unanimë, pra secili ka thënë po. Nuk është mirë askush të provojë të heqë taksën pa thënë secili po", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka mohuar se i ka ndërruar fjalët për marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi. Haradinaj është shprehur i bindur se kufiri në mes të Kosovës dhe Malit të Zi do të jetë në Çakorr. "Çka duhet t'i japim Serbisë për njohje? Le ta harrojë çdokush se kemi për t'i dhënë tokë, territor e kufij. Nuk është e vërtetë që ne i kemi luajtur fjalët për demarkacionin me Malin e Zi. Me marrëveshje të shkruar ne kemi rënë dakord që ta korrigjojmë atë marrëveshje. Parlamenti i vendit e ka votuar bashkë me atë marrëveshje edhe raportin e komisionit shtetëror të z. Bulliq, i cili e nje gabimin e bërë më herët dhe parashih korrigjimin. Kufiri është në Çakorr dhe Kullë", ka thënë Haradinaj. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian i kanë kërkuar Prishtinës zyrtare që ta pezullojë taksën 100 për qind e cila është në fuqi që prej nëntorit të vitit të kaluar. Përveç ambasadorit amerikan në Prishtinë, edhe shumë zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë kanë kërkuar pezullimin

e taksës. Madje javën e kaluar përfaqësuesit e lartë të Kosovës kanë pranuar një letër nga zyrtarë të lartë amerikanë, të cilët kanë shprehur zhgënjimin e tyre lidhur me mospezullimin e taksës ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina. Në letër të cilën e kanë nënshkruar ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, ndihmëssekretarja e Mbrojtjes, Laura Cooper dhe zëvendës drejtori për Çështje Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, John Earth, është thënë se "është e pabesueshme që pas gjithë çfarë kemi bërë bashkë, Kosova e vlerëson miqësinë tonë aq ulët sa t'i injorojë këshillat tona". Po ashtu, në shenjë pakënaqësie qeveria amerikane ka anuluar vizitën e planifikuar të gjeneralit Orr nga Garda Kombëtare e Iowas në Kosovë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, vazhdimisht ka ftuar Qeverinë e Kosovës që ta respektojë kërkesën amerikane dhe ta pezullojë taksën. Me idenë për pezullimin e tarifës në një afat prej 120 ditëve ka dalë edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Por, kryeministri Ramush Haradinaj po insiston se taksa 100 për qind do të mbetet në fuqi derisa Kosovën ta njohë Serbia.

Arrestohen dy persona të dyshuar për "trafikim të njerëzve"

Prishtinë, 18 shkurt (ER) - Policia e Kosovës gjatë realizimit të detyrave dhe autorizimeve, në funksion të garantimit të rendit dhe sigurisë së përgjithshme, si dhe parandalimit të veprave penale, të hënën rreth orës 1:30,

në rajonin e Prizrenit, në Dragash, ka identifikuar dhe ndaluar një veturë me targa vendore, me ç'rast, pas një procesi të verifikimit dhe kontrollit, në bashkëpunim me zyrtarë të Drejtorisë së Antitrafikimit të

Njerëz, janë arrestuar dy persona nën dyshimin për "trafikim të njerëzve" si dhe janë identifikuar tri viktima të trafikimit (të gjitha femra/shqiptare /kosovare). Personat e dyshuar janë intervistuar dhe me vendim të

prokurorit kompetent janë ndaluar për 48 orë. Viktimat janë dërguar për ekzaminim mjekësor dhe janë ndërmarrë veprimet për strehimin e tyre sipas procedurave të parapara për raste të tilla.



'OrganicHerb' prezantuese e produkteve organike të Kosovës dhe Shqipërisë në Nuremberg



NUREMBERG, 18 SHKURT (ER) - Kompania "OrganicHerb" në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka marrë pjesë në panairin "Biofach" që është mbajtur në Nuremberg të Gjermanisë më 13 deri më 16 shkurt.

"Biofach" është panair në të cilin promovohen ushqimet organike. Kompania "OrganicHerb", që është kompani kosovare, i ka

promovuar produktet e veta të kultivuara dhe të egra, si: fruta mali, bimë mjekuese, aromatike etj., para blerësve dhe vizitorëve nga shtete të ndryshme pjesëmarrëse në këtë panair.

Ky panair është një mundësi e mirë për kompanitë e Kosovës që të takohen me prodhues profesionalë të ushqimit organik dhe të njihen me trendet e fundit të këtij sektori. Kompaninë "OrganicHerb" mund ta vizitoni edhe në uebin www.organicherb.info dhe ta telefononi në: +383 44 515 171.

Zhvillimi ekonomik, peng i aktiviteteve joligjore

Prishtinë, 18 shkurt - Krimi ekonomik, evazioni fiskal, ekonomia joligjore dhe shkalla e lartë e korrupsionit janë disa prej problemeve që e kanë përcjellë Kosovën në këta 11 vjet të pavarësisë, e të cilat po vlerësohet se kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e saj ekonomik. Me gjithë të arriturat në aspektin ekonomik, këto fenomene negative kanë penguar zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në vend, thonë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësues të komunitetit të bizneseve.

Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se këto fenomene janë trashëguar nga qeveritë e kaluara, por që ende janë të pranishme. "Për këta 11 vjet jemi duke u ballafaquar me probleme relativisht të mëdha në aspektin e zhvillimit ekonomik. Krejt aktivitetet ekonomike ende po karakterizohen me shkallë të lartë të informalitetit, evazionit fiskal, me krim ekonomik i cili



është relativisht i organizuar dhe i lartë dhe normalisht me shkallë të lartë të korrupsionit. Ne jemi të vetëdijshëm se këto probleme i kemi trashëguar, e dimë se ekzistojnë, janë të pranishme dhe e dimë se duhet të luftohen", ka thënë Shatri.

Edhe Aleanca Kosovare e Biznesit disa herë ka publikuar raporte që pasqyrojnë fenomenet negative në Kosovë, të cilat kanë penguar zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Kryetari i kësaj aleançe, Agim Shahini, ka

thënë për "Radion Evropa e Lirë" se këto fenomene mund të eliminohen nëse ekziston guximi dhe vullneti i spektrit politik. "Ekonomia e vendit vuan nga disa sëmundje, por askush nuk ka guxim dhe gatishmëri për t'i shëruar këto sëmundje. Këto janë ekonomia joformale, krimi ekonomik, korrupsioni dhe pastrimi i parave e haraçi. Këto fenomene mund të eliminohen vetëm nëse institucionet e Kosovës do të kenë gatishmëri dhe pajtueshmëri politike për ta

shëruar vendin njëherë e përgjithmonë nga këto, në mënyrë që t'i hapet ekonomisë së vendit perspektiva, investimet e huaja për të cilën Kosovës i ka munguar vazhdimisht", ka theksuar Shahini.

Edhe Bashkimi Evropian në fund të vitit të kaluar u ka kërkuar institucioneve të Kosovës që të bëjnë edhe më shumë në kuadër të luftimit të korrupsionit, krimit të organizuar, por edhe terrorizmit.

Në anën tjetër, zyrtarë qeveritarë tashmë sa herë kanë pohuar se lufta kundër këtyre krimeve është përparësi e institucioneve të Kosovës. Madje, për luftimin e kësaj dukurie janë krijuar disa strategji dhe vizione ekonomike. Në strategjinë kombëtare për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve ekonomike për vitin 2014-2018, thuhet se do ta reduktojë shkallën e ekonomisë joformale në 5 për qind mes 2014-s dhe 2018-s.

Kurse gjatë vitit 2015 deri në 2018-n vlera e konfiskimit të të ardhurave nga krimi duhet të jetë 1 milion euro për vit.

Por, Agim Shahini thotë se, përveç shpenzimeve të mjeteve buxhetore për përgatitjen e këtyre dokumenteve, në terren situata është e njëjtë. "Pikërisht për këtë ka pasur iniciativë të ndryshme nga shteti, duke krijuar strategji e duke shpenzuar miliona euro edhe për udhëtime të shumta. Jemi dëshmitarë të vizionit të zhvillimit ekonomik të Kosovës (i njohur si plani Banskò), që është miratuar nga Qeveria dhe asnjëherë nuk është zbatuar. Tentime të ndryshme, por realizimet mbeten ditore që i kërkon politika", ka thënë Shahini.

Sidoqoftë, me ndryshimet e bëra në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar të këtij viti, mundësohet ndjekja efektive e aktiviteteve kriminale në kontekstin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, rrjedhimisht janë ashpërsuar edhe dënimet.

VESELI NË FORUMIN E INVESTITORËVE GLOBALË PARAQET POTENCIALET QË OFRON KOSOVA



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

STAMBOLL, 18 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë në hapje të Forumit Botëror të Investitorëve "World Business Angels Investment Forum" (WBAF), i cili po mbahet në Stamboll të Turqisë, e ku po marrin pjesë liderë të vendeve të ndryshme të Ballkanit, Evropës dhe Afrikës. Kreu i Kuvendit të Kosovës u

prezantua nga organizatorët e forumit si një prej liderëve më inovatorë në Ballkan, i cili ka promovuar dhe mbështetur të rinjtë në fushën e teknologjisë informative në Kosovë. "Ne synojmë të promovojmë një zhvendosje nga kreditë në financimet e orientuara nga investimet për sipërmarrjet dhe startapet, duke reflektuar rëndësinë e ndarjes së riskut ndërmjet sipërmarrësve dhe institucioneve financiare. Në një kohë kur bota është më e

ndërlidhur se kurrë, ne kemi mundësi të ndihmojmë më shumë njerëz të kenë qasje në kapital dhe burime e rrjete që ata kanë nevojë për sukses", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Kreu i Kuvendit të Kosovës ka folur para të pranishmëve për potencialet e jashtëzakonshme që ofron Kosova dhe të rinjtë e saj me ide inovative të cilët tashmë janë dëshmuar për sukses. "Sot po u bëj thirrje qeverive, kompanive, organizatave dhe individëve që ta vizitojnë

Kosovën dhe të gjejnë mundësi partneriteti me kosovarët inovatorë. Ka të rinj të shkëlqyeshëm, gra të palodhura dhe mendimtarë të rinj nga komunitetet anembanë botës, të gatshëm për të bërë ndryshime. Së bashku, mund t'i ndihmojmë të gjithë ata që kanë kreativitet. Unë angazhohem të punoj shumë për ndërtimin e një mjedisit të fortë dhe të qëndrueshëm për sipërmarrësit dhe inovatorët", ka thënë Veseli. Edhe ministri i Inovacionit dhe

Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë në Forumin e përvitshëm të Investitorëve Engjëj (World Business Angels Forum-WBAF). Beqaj gjatë fjalimit të tij në panelin ministror, ndër të tjera, ka diskutuar për rëndësinë e teknologjisë si një ndër sektorët më me peshë për zhvillim ekonomik të vendit. Në këtë forum pritet të nënshkruhet edhe një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe WBAF.

Shpërthim në veri të Mitrovicës

MITROVICË, 18 SHKURT - Rreth orës 3:00 të mëngjesit të së hënës në veri të Mitrovicës ka ndodhur një shpërthim afër një lokali. Lajmin për "Radion Evropa e Lirë" e ka konfirmuar zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Besim Hoti. Ai ka thënë se nuk ka të lënduar, por vetëm disa dëme materiale. "Shpërthimi ka

ndodhur rreth orës të 3:00 të mëngjesit. Ende nuk dihen motivet e këtij incidenti. Policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe hetimet janë në fazën fillestare. Kryesit e këtij veprimi ende janë të panjohur për policinë", ka thënë Hoti. Sipas tij, në zonën e këtij incidenti janë thyer xhamat e një ndërtese si dhe të një veture.



'Let's Do It' pastron pikën kufitare në Han të Elezit

HANI I ELEZIT, 18 SHKURT (ER) - Për nder të 11 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, "Let's Do It" ka organizuar aksion pastrimi te pika kufitare me Maqedoninë, në Han të Elezit, te pllaka përkujtimore "Eksodi 99", nga ku dhjetëra vullnetarë kanë larguar afër 100 thasë me mbeturina.

Aksionit iu bashkuan kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, zyrtarë të tjerë komunalë, zjarrfikësit, si dhe nxënës të Shkollës së Mesme

"Dardania", kurse largimin e mbeturinave të grumbulluara e ka bërë Kompania "Pastrimi". Drejtori ekzekutiv i "Let's Do It", Luan Hasanaj, ka thënë se, pavarësisht se të njëjtat hapësira janë pastruar vitin e kaluar, edhe këtë vit ato kanë qenë të mbushura nga mbeturinat. Ndërsa kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Refki Suma, ka thënë se shpreson që aksione të tilla të ndikojnë në vetëdijesimin e qytetarëve për mirëmbajtjen e mjedisit të pastër.



Zbulohet pllaka falënderuese në Deçan për gjeneralin Mattis

DEÇAN, 18 SHKURT (ER) - Në 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, në Komunën e Deçanit është bërë zbulimi i pllakës falënderuese për gjeneralin James Mattis. Në këtë

pllakë shkruan: "Përjetësisht mirënjohës nga populli i Kosovës". Zbulimin e kësaj pllake e ka bërë kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj.

Kjo mirënjohje është për kontributin e veçantë që ish-sekretari i Mbrojtjes së ShBA-së ka dhënë për themelimin e ushtrisë së Kosovës.



Kryeministri bën homazhe në Glogjan

GLOGJAN, 18 SHKURT (ER) - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë të hënën homazhe në varrezat e dëshmorëve në Glogjan. Ai ka thënë se

dëshmorët e kombit, vlerat e lirisë dhe atdheut i vendosen mbi gjithçka tjetër. "Në 11-vjetorin e pavarësisë së Kosovës, sot në Glogjan bëra homazhe, në nder-

im të sakrificës sublime të dëshmorëve e heronjve, të cilët vlerat e lirisë dhe atdheut i vendosën mbi gjithçka tjetër. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Haradinaj.

Dialogu Kosovë - Serbi po rikthehet në binarët e duhur



Prof. Lisen BASHKURTI

Kosova po tregohet e hapur, e angazhuar dhe plotësisht e vullnetshme për ta vijuar dialogun me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre përmes një marrëveshje transparente, të gjerë, gjithëpërfshirëse, ligjërish të obligueshme dhe të mbështetur ndërkombëtarisht nga BE-ja dhe ShBA-ja.

Këto ditë në Kosovë janë hedhur dy hapa shumë të rëndësishëm në këtë aspekt. U ndërtua ekipi negociator në nivel shtetëror dhe me përbërje të gjerë e gjithëpërfshirëse. Ekipi, pas konsultave të shumta politike, diplomatike dhe ekspertizave, punoi për përgatitjen e platformës së dialogut në këtë fazë përfundimtare. Kjo platformë është paraqitur Kuvendit të Kosovës për diskutim të hapur politik, për debate, për përmirësim dhe miratim. Me këtë rast edhe opinioni publik mbarëkosovar do të njihet me këtë platformë që përbën tërësinë e parimeve dhe objektivave me të cilat ekipi negociator i Kosovës do të marrë pjesë në dialogun me Serbinë.

1. Përmirësimi i pozicionit negociues dhe ndërkombëtar i Kosovës

Këtij procesi drejt dialogut të Kosovës me Serbinë i kanë paraprirë edhe disa masa jashtënegociatore të ndërmarra nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, por me efekte të drejtpërdrejta në krijimin e një mjedisi më të balancuar midis palëve negociuese. Dy janë masat jashtënegociatore që e kanë përmirësuar pozicionin e palës së Kosovës në dialogun me palën serbe. Së pari, krijimi i forcave të armato-

ura të Kosovës. Ky vendim ka përmbyllur krijimin e kuadrit të plotë institucional të shtetit të pavarur të Kosovës. Kjo ushtri po formësohet mbi parimet politike, demokratike dhe ushtarake të strukturës së NATO-s dhe ka si synim të plotë anëtarësimin në këtë organizatë euroatlantike. Së dyti, është vendosja e tarifës 100 për qind të importeve të mallrave nga Serbia drejt Kosovës. Kjo masë është në të drejtën sovranë të shtetit të Kosovës si masë mbrojtëse nga politika dhe diplomacia agresive e Serbisë, e cila ka shkelur angazhimet e saj të marra në marrëveshjen kuadër të Brukselit të prillit 2013 dhe nuk ka zbatuar shumicën nga 23 marrëveshje të tjera të negociuara deri në vitin 2018.

Krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës dhe aplikimi i tarifës 100 për qind për importet serbe në Kosovë janë dy masa që kanë ndeshur me qasje diverse në mjedisin e brendshëm të Kosovës dhe në arenën ndërkombëtare. Mbështetësit dhe kundërshtuesit e këtyre dy masave përdorin argumente të ndryshme për t'i promovuar synimet e tyre dhe për t'i mbrojtur interesat e veta politike apo gjeopolitike ndërkombëtare.

Pa hyrë në këtë debat mund të thuhet pa kurrfarë hezitimi se këto dy masa, me gjithë kundërshtitë që kanë hasur, sërish kanë rifaktorizuar pozitivisht pozicionin e Kosovës në raportet me Serbinë si dhe kanë rivënë sërish çështjen e Kosovës në agjendën ndërkombëtare, kryesisht në ShBA dhe në BE. Pra, këto dy masa në tërësi kanë qenë dhe mbeten të dobishme për Kosovën dhe pa efekte anësore për paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.

2. Platforma e dialogut e dobishme, e drejtë dhe e zbatueshme

Këto ditë në Kuvendin e Kosovës është paraqitur platforma e dialogut me Serbinë për arritjen e një marrëveshje të gjerë, gjithëpërfshirëse dhe për-

fundimtare. Platforma do t'i nënshtrohet një debati të hapur parlamentar, që i jep mundësi edhe opinionit publik të informohet dhe të përfshihet në këtë debat me interes mbarëkombëtar. Platforma përmban kuadrin e parimeve kryesore si dhe temat e bisedimeve. Parimi i parë ka të bëjë me njohjen e Kosovës nga Serbia me anë të katër premtiveve ose angazhimeve detyruese ligjërish që lidhen me tërheqjen e objeksioneve të Serbisë në OKB kundër pranimit të Kosovës: ndalimin e aktiviteteve që pengojnë Kosovën në rrugën drejt njohjes ndërkombëtare si shtet i pavarur dhe sovran; respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës; ndalimin e objeksioneve ose inkurajimin e palëve të treta ta kundërshtojnë aplikimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizatë ndërkombëtare duke përfshirë OKB-në, Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe agjencitë e tyre; heqjen dorë nga të gjitha format e ndërhyrjes së Serbisë në punët e brendshme si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës; si dhe themelimin e një tribunali të ri "për hetimin dhe gjykimin e kriminelëve të luftës nga Serbia në Kosovë në vitet 1998-1999". Parim tjetër i rëndësishëm i platformës është ai që lidhet me ruajtjen e tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës. Në platformë theksohet se territori i Kosovës nuk do të shkëmbehet. Qartazi ky parim i platformës nuk është as më pak dhe as më shumë, por parashikimi kushtetues i Republikës së Kosovës që thekson se Kosova është vend i pandashëm. Ky parim parandalon çdo përpjekje brenda dhe jashtë negociatave që synon, nën "argumente" të ndryshme, ta cenojë tërësinë dhe integritetin territorial ekzistues të Republikës së Kosovës, të njohur më 17 shkurt 2008.

Gjithashtu, ky parim i përfshirë në platformën e bisedimeve me Serbinë synon t'i japë fund, me

vullnetin e sovranit, debatit midis presidentit Thaçi dhe mbështetësve të tij brenda dhe jashtë Kosovës, si iniciuesi i ndryshimeve territoriale midis Kosovës e Serbisë dhe kryeministrit Haradinaj e mbështetësve të tij brenda dhe jashtë Kosovës, si mbrojtës i pacenueshmërisë territoriale të Kosovës.

Aspektet e tjera shumë të rëndësishme janë përfshirë në platformën e bisedimeve. Këto lidhen me problemin madhor të personave të humbur gjatë periudhës së luftës, atë të viktimave të abuzimeve seksuale në atë periudhë, çështja e reparacioneve për dëmet kolaterale të shkaktuara mbi Kosovën gjatë luftës.

Të gjithë këto aspekte do të jenë pjesë e negociatave midis Kosovës dhe Serbisë.

Në tërësinë e tyre parimet e platformës së bisedimeve Kosovë - Serbi, të paraqitura nga grupi negociator i Kosovës për diskutim e miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, synojnë që të garantojnë paqe të qëndrueshme në të gjithë rajonin. Sipas platformës, gjithsecili duhet ta ketë të qartë se Kosova po shkon për bisedime në Bruksel për njohjen e saj. Kjo ka rëndësi për të kuptuar se nuk negociohet për statusin e Kosovës, që tanimë është i përcaktuar, i njohur ndërkombëtarisht dhe i konfirmuar si legjitim nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë si realitet i pakthyeshëm, por negociohet vetëm për pranimin e këtij realiteti nga pala serbe.

Është me rëndësi të theksohet gjithashtu, që në përputhje me platformën, marrëveshja përfundimtare midis Prishtinës dhe Beogradit do të hyjë në fuqi vetëm mbasi: a) Serbia ta njohë Kosovën, b) të mbahet referendumi në Kosovë mbi marrëveshjen dhe, c) marrëveshja të ratifikohet nga parlamentet e të dy vendeve respektive.

E vështruar në tërësi, platforma e paraqitur nga grupi shtetëror negociator i Kosovës për bisedimet me Serbinë ka një kuadër parimesh të qarta dhe temash të rëndësishme në

agjendën e saj. Platforma respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që është bazuar në parimet e Paketës së Ahtisarit, që përmban në vetvete një zgjidhje kompromisi të gjerë midis Kosovës dhe Serbisë, kompromis përtej të cilit nuk mund të shkohet pa vënë në rrezik serioz vetë statusin e Kosovës si dhe paqen brenda saj dhe paqen në rajon.

3. Momenti shënon lëvizje nga stanjacioni

Momenti i paraqitjes së platformës është pikërisht kur vërehet një vëmendje në rritje ndaj problemit Kosovë - Serbi në qendrat e mëdha ndërkombëtare, siç janë ShBA, Gjermania, Britania dhe BE-ja në tërësi, sikundër vërehet edhe agresivitet në rritje i Rusisë dhe faktorëve të tretë ndërkombëtarë, që kundërshtojnë zgjidhjet në dobi të njohjes së pavarësisë së Kosovës, integrimin euroatlantik të rajonit si dhe vetë paqen e stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Këta dy vektorë gjeopolitikë kundërshtues duket se ndajnë qasjet politike dhe gjeopolitike edhe midis Kosovës dhe Serbisë deri tani. Nga ana tjetër, duhet të dihet qartësisht se të dy vendet, si Kosova ashtu dhe Serbia, kanë trajektore të përbashkët drejt BE-së. Rruga drejt BE-së është e qartë. Koha e arritjes së saj është ende e paqartë. Bisedimet Kosovë - Serbi synojnë, ndër të tjera, ta qartësojnë dhe të shkurtojnë edhe kuadrin kohor të afrimit të të dy vendeve drejt Bashkimit Evropian.

Për kohën e dhënë, situata politike midis Kosovës dhe Serbisë duket mjaft e ndërë dhe tensionuar kryesisht për shkak të insistimit serb për mosnjohjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, nga njëra anë, edhe masave mbrojtëse të forta tarifore të vendosura nga Kosova kohët e fundit kundër importit të produkteve serbe. Sidoqoftë, lypset të theksohet se situata duket se po lëviz pas një periudhe të gjatë stanjacioni.

Mbi 60 të rinj i bashkohen PDK-së në Gjilan

GJILAN, 18 SHKURT (ER) - Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjilan i janë bashkuar 60 të rinj. Lajmi është bërë me dije nga ky subjekt politik në Gjilan. Sipas njoftimit për media të PDK-së në këtë komunë,

këtyre të rinjve u ka uruar mirëseardhje kryetari i Rinisë së PDK-së, Donjet Bislimi, kryetarja e rinisë së PDK-së në Gjilan, Erlehta Osmani, dhe zëvendësiministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Leonora Morina-

Bunjaku. "'Dekada e Re' është shembull i zhvillimit dhe integritetit, platformë e cila po i bashkon mijëra të rinj anekënd Kosovës", është bërë me dije në njoftimin për media të PDK-së në Gjilan.



Shtatë deputetë largohen nga Partia Laburiste në Britani

LONDËR, 18 SHKURT - Shtatë deputetë të Partisë Laburiste janë larguar nga kjo parti për shkak të pakënaqësive ndaj qëndrimeve të udhëheqësit të saj, Jeremy Corbyn, për çështjen e Brexitit dhe antisemitizmit. Shtatë deputetët e dorëhequr e kanë krijuar grupin e tyre parlamentar, i cili do të quhet "Grupi i pavarur". Deputetët e dorëhequr nga Partia Laburiste janë: Chuka Umunna, Luciana Berger, Chris

Leslie, Angela Smith, Mike Gapes, Gavin Shuker dhe Ann Coffey.

Deputetja Luciana Berger ka thënë se Partia Laburiste është bërë parti antisemite dhe se ndihet e turpëruar për të qëndruar në këtë parti.

Ndërsa deputeti Chuka Umunna ka thënë se nuk do t'u bashkohen partive të tjera sepse ato janë pjesë e problemit e jo pjesë e zgjidhjes, shkruan "BBC".

"Është koha që ta hedhim poshtë këtë politikë të vjetruar të shtetit", ka thënë ai. Sipas tij, Britania e Madhe ka nevojë për një parti që e anashkalojnë politikën fisnore. "Askush nuk duhet t'i bashkohet një partie politike për të luftuar kundër njerëzve që janë brenda saj", ka deklaruar Umunna.

Ndërsa deputetja Ann Coffey ka thënë se grupi i ri do të punojë për ta ndryshuar sistemin politik



që i ka bërë të ndihen sikur nuk po u dëgjohej zëri. Coffey ka theksuar se vlerat dhe parimet e

tyre nuk kanë ndryshuar, pavarësisht ndërrimit të grupit politik.

Evropianët heshtin pas mesazhit të presidentit Trump për ISIS-in

Presidenti Donald Trump shkroi të dielën në "Twitter" se "Kalifati është gati të bjerë" por, në anën tjetër, aleatët e mbledhur në Konferencën e Sigurisë të Mynihut këtë fundjavë nuk ishin aq të sigurt

MYNIH, 18 SHKURT - Aleatët evropianë kanë ofruar një përgjigje të heshtur ndaj kërkesës së presidentit Trump që ata të marrin mbrapsht qytetarët e tyre të kapur duke luftuar për Shtetin Islamik në Siri. Presidenti tha se grupi terrorist është në prag të humbjes, megjithëse shumë analistë janë të shqetësuar se Shteti Islamik mbetet i aftë për të kryer sulme. Shteti Islamik dikur kontrollonte mbi 100 000 kilometra katrorë territor dhe së paku tetë milionë njerëz. Tani grupi terrorist është reduktuar në një rajon të vogël brenda qytetit Baghuz, nën sulme të ashpra nga Forcat Demokratike Siriane të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara.

Presidenti Donald Trump shkroi të dielën në "Twitter" se "Kalifati është gati të bjerë". Por, aleatët e mbledhur në Konferencën e Sigurisë të Mynihut këtë fundjavë nuk ishin aq të sigurt. "Ka territore që janë çliruar, por

ISIS-i apo terrorizmi ende nuk është mposhtur, sepse ideologjia vazhdon të jetë, njerëzit janë ende atje dhe shkaqet e rekrutimit mbeten njëloj", thotë ministri i Jashtëm i Katarit. Eksperti i radikalizmit, Peter Neumann, thotë se Shteti Islamik ende ka mijëra luftëtarë. "Jo të gjithë janë në ato territore që po merren. Shumë prej tyre janë fshehur. Ata janë në Mosul, në Raka, ata janë duke pritur për t'u kthyer", thotë profesori Meumann.

Presidenti Trump shkroi se Evropa duhet të marrë mbrapsht mbi 800 luftëtarë të Shtetit Islamik të kapur në Siri ose, përndryshe, Shtetet e Bashkuara mund të detyrohen t'i lirojnë dhe kjo do të bënte që ata të "depërtonin në Evropë", tha presidenti. "Aleatët duhet ta marrin parasysh mirë mesazhin", i tha "Zërit të Amerikës" ish-kongresisti republikan Darell Issa. "Në të kaluarën evropianët kanë



kërkuar që ne t'i lirojmë luftëtarët që kemi mbajtur në Guantanamo, duke mos i mbajtur përgjegjëse këto vende. Dhe, si rezultat, ata janë kthyer në fushën e betejës, ose kanë kryer terrorizëm në vendet e tyre. Evropianët shpresoj se kanë mësuar nga kjo dhe janë të përgatitur t'i marrin këta luftëtarë dhe t'i mbajnë ata përgjegjës", thotë ish-kongresisti republikan. "Duhet të ekzistojë një parim i

thjeshtë, sipas të cilit, çdo vend duhet të kujdeset dhe ta marrë përgjegjësinë për qytetarët e vet", thotë analisti Neumann. Por, mesazhi i presidentit Trump në "Twitter" është i pasjellshëm ndaj aleatëve, argumenton analisti i sigurisë, Karin von Hippel. "Ky është një problem i zakonshëm, një sfidë e zakonshme. Shteti Islamik ka të ngjarë të sulmojë po aq sa evropianët, edhe amerikanët ose asetet amerikane në vendet

evropiane", thotë ai. Shumica e liderëve evropianë deri tani nuk u janë përgjigjur mesazheve të presidentit Trump në "Twitter". Presidenti nuk ishte i pranishëm në konferencë, por mesazhet e tij në "Twitter" kanë dominuar bisedat dhe kanë përqendruar mendjen e të pranishmëve në pyetjen nëse Shteti Islamik vërtet është mposhtur apo do të kthehet edhe një herë si një kërcënim për botën.

Bjellorusia zotohet për partneritet me BE-në



Minuk, 18 shkurt - Presidenti i Bjellorusisë, Alyaksandr Lukashenko, tha se vendi i tij gjithmonë do të jetë "partner i Bashkimit Evropian". Pas takimit me Komisionarin Evropian për Buxhet dhe Burime Njerëzore Gunther Oettinger, presidenti Lukashenko tha se problemet në mes të BE-së dhe

Bjellorusisë kanë ekzistuar gjithmonë, "por ato nuk kanë karakter kronik dhe mund të zgjidhen". Takimi i Lukashenkos me Oettinger u mbajt vetëm pak ditë pasi ai vizitoi Rusinë, ku bisedoi me presidentin rus, Vladimir Putin, mbi bashkëpunimin e mëtejshëm të

të dy vendeve. BE-ja ka lehtësuar sanksionet kundër Bjellorusisë në vitin 2016, pas lirimit të disa të burgosurve politikë, por kritikoi qeverinë e Lukashenkos për përdorimin e forcës ndaj protestuesve, të cilët kishin dalë të protestonin kundër papunësisë. Lukashenko është në pushtet që nga viti 1994.

Ruhani: ShBA-ja po zhvillon luftë ekonomike kundër Iranit

Teheran, 18 shkurt - Presidenti i Iranit i përshkroi sanksionet e Shteteve të Bashkuara ndaj Iranit si një luftë ekonomike, duke theksuar se "lufta ekonomike është më e vështirë sesa ajo ushtarake".

Hasan Ruhani i bëri këto komente të hënën, në një ceremoni për inaugurimin e rafinerisë së naftës së Gjirit Persik, të ndërtuar në qytetin-port Bandar Abbas. Ndërtimi i rafinerisë filloi në vitin

2006 dhe ajo ka kapacitetin për të prodhuar 400 000 fuçi në ditë, rreth 20 për qind të kapacitetit të prodhimit të naftës që ka tani Irani - më tepër se 2 milionë fuçi në ditë. Administrata Trump vitin e kalu-

ar u tërhoq nga marrëveshja bërthamore e Iranit me fuqitë botërore dhe rivendosi sanksionet ndaj Teheranit. Sanksionet amerikane prekin sektorin e prodhimit të naftës, me rëndësi jetike për Iranin.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E rrallë

"Barbie", tani edhe në karrige me rrota

Pas 60 vjetësh histori, "Barbie" vazhdon të mahnitë, të jetë aktuale dhe të përfaqësojë në mënyrë gjithnjë realiste botën që e rrethon. Linja "Barbie Fashionista" propozon lloje të ndryshme kukullash: bionde, ezme, të gjata, të shkurtra, të dobëta, të kolme, por edhe në karrige me rrota dhe me proteza në këmbë. E gjithë kjo është bërë për t'i nxjerrë në pah llojet e ndryshme të gjendjes fizike dhe problemeve. Kim Culmone, zëvendëspresidente e "Barbie Design" të Mattelit, ka thënë se ky model ka qenë një prej më të kërkuarave nga konsumatorët.



BARSOLETA E DITËS



Buri dhe gruaja po shikonin një film horror kur, pas një skene, ngrihet gruaja e bërtet: - Uaaaa mami, çfarë tmerri! la kthen i shoqi: - Edhe ty të ngjasoj?! Edhe mua si jot ëmë m'u duk.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



FOTO E DITES



Republika e Kosovës të dielën shënoi 11-vjetorin e shpalljes së pavarësisë. Në fotografi shihet parakalimi i ushtarëve.

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



E jashtëzakonshme

Gjendet diamanti i rrallë 300 milionë vjeçar në formë zemre

Një diamant i rrallë në formë zemre është zbuluar në Rusi. Diamanti u gjet në fund të muajit janar në Yakutia. Ekspertët thonë se guri me vlerë është 65.7 karat dhe vlerësohet të jetë 300 milionë vjeçar. Diamanti ra shumë në sy për shkak të formës së veçantë.



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Ditët e fundit keni hasur në pengesa që


nuk ju kanë lejuar të shihni qartë sa i përket gjendjes suaj të rënduar shpirtërore.



DEMI

Një ditë e tërë në shoqërinë e vetes suaj sot

mund t'ju bëjë veçse mirë. Ju shijon të ecurit në rrugë shpënguar ose vajtja në aktivitete kulturore.



BINJAKËT

Edhe pse nuk keni gjithçka nën kontroll,

kjo nuk do të thotë se nuk menaxhoni dot punën tuaj. Jeni mjaft korrekt kur bëhet fjalë për profesionalizëm.



GAFORRJA

Nuk mund të lejoni që personat tuaj të afërt të

jenë neglizhentë me një çështje të caktuar. Falë ndërhyrjes suaj gjërat do të rregullohen.



LUANI

Keni shumë gjëra që kanë lidhje

me administratën sot për të mbyllur dhe do t'ju duhet ta nisni ditën më herët se zakonisht.



VIRGJËRESHA

Nëse doni t'i vëni nën presion

personat afër jush ose bashkëpunëtorët, sot do t'ia arrini qëllimit. Nuk është e thënë që kjo sjellje është e mirë.



PESHORJA

Njerëzit pranë jush e kanë harruar sa

person i bukur jeni në shoqëri. Kjo sepse ju jeni shmangur prej kohësh kontaktit me të tjerët.



AKREPI

Kushtet komode që keni pasur i keni rifituar

kohët e fundit dhe kjo gjë ju pëlqen të zgjasë sa më shumë. Do të kërkonit kontakte të reja.



SHIGJETARI

Keni rifituar terrenin e humbur në

një çështje personale. Kjo gjë ju ka bërë të bindeni që mjafton pak këmbëngulje dhe mund t'ia dilni.



BRICJAPI

Jeni pak të ndrojtur në kontaktin e

parë me të panjohurit. Më pas bëheni shumë shpejt protagonist i situatave.



UJORI

Nëse nuk doni që dikush t'ju verë me

shpatulla për muri dhe t'ju kërkojë llogari, duhet patjetër të përfundoni atë që keni nisur deri në mesditë.



PESHQIT

Mbase mbi disa argumente që nuk keni

dijeni nuk keni pse debatoni. Do të tregonit që jeni të painformuar mirë lidhur me tema të caktuara.


Katy Perry mund të lë muzikën për të krijuar familje



Këngëtarja Katy Perry para disa ditësh ishte fejuar me Orlandon Bloom. Një burim për "People"


ka thënë se Katy ka thënë se është në gjendje ta lë karrierën e muzikës për të bërë një fëmijë me Orlandon.

Fejohet Kylie Jenneri?



Kylie Jenner ka shkaktuar përsëri spekulime për një fejesë. 21-vjeçarja bëri një video të shkurtër në "Instastory" në të cilën i shihej një unazë e madhe diamante. Kylie shihet duke i dhënë makinës ku edhe e ka

shfaqur dorën e majtë. Ajo edhe më herët ka nxitur thashetheme duke treguar unaza të mëdha mirëpo, meqenëse Shën Valentini sapo kaloi, fansat po supozojnë se Travis Scott i propozoi martesë atë ditë.




Sofia Richie shkëlqen në të bardhë

Modeluesja e njohur Sofia Richie është fotografuar nga paparacët teksa ecte

në rrugët e Miamit. Richie pati të veshur një fustan të bardhë i cili i rrinte shumë bukur.

Lil Xan po bëhet baba



22-vjeçari, emri i të cilit është Nicholas Diego Leanos, përmes "Instagram"-it ka njoftuar se ai dhe e dashura e tij Annie Smith do të bëhen prindër. "Doja të pritja por,

thjesht, nuk mund t'i lija fansat e mi në errësirë. Është zyrtare, do të bëhem baba. Ju dua shumë dhe shpresoj se ju të qëndroni së bashku me mua në këtë udhëtim", ka shkruar Lil Xan.

'Fitorja diplomatike', një libër dritëhedhës mbi diplomacinë e UÇK-së

Lulëzim ETEMAJ

"Fitorja diplomatike", kështu titullohet libri më i ri i diplomatit Sabri Këçmarit, përfaqësues diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë kohës së luftës dhe, pas çlirimit dhe shpalljes së pavarësisë, ambasador i shtetit të Kosovës. Libri ka dalë nga shtypi në vitin 2017, ndërsa është botuar nga gazeta e përditshme "Epoka e re". Libri "Fitorja diplomatike", i sjellë në formë të kujtimeve të autorit, të kombinuara edhe me shënime ditari, intervista, deklaratat e komunikata, është një libër i rrallë, i karakterit historik shkencor, që për trajtim e ka përfaqësimin diplomatik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në periudhën kohore të luftës në Kosovë nga data 4 mars 1998 deri më datën 22 qershor 1999, kohë kur Kosova ishte çliruar nga pushtimi i Serbisë dhe e kishte fituar lirinë.

Protagonisti kryesor i librit është vetë autori.

Duke qenë të përfshirë në libër edhe protagonistë të tjerë të diplomacisë së UÇK-së, qoftë shkaku i bashkëpunimit dhe bashkërendimit që ka me ta Sabri Këçmarit, qoftë shkaku i informimit që ai ua bënë lexuesve për veprimtarinë diplomatike të tyre, sado që në mënyrë fragmentare, libri në periudha të caktuara i tejkalon përmasat e një ditari personal, ndërsa diplomacinë e UÇK-së e bën t'i tejkalojë përmasat subjektive, duke nxjerrë në sipërfaqe çaste dhe pjesë të shumëdimensionalitetit të saj.

Autori i librit në kohën e përfaqësimit diplomatik të UÇK-së nuk është një diplomat i karrierës, i cili profesion dhe detyrë kryesore e ka përfaqësimin e vendit të tij në një shtet të huaj, pas emërimit që i bëhet nga institucioni përgjegjës i shtetit. Përkundrazi. Ai ishte veprimtar politik, një veprimtar politik i përndjekur, që vite më parë kishte qenë sekretar organizativ i Lëvizjes dhe, krahas Afrim Zhitisë dhe Fadil Vatës, një nga bashkëdrejtuesit e Lëvizjes në Kosovë, e cila në fokus të veprimtarisë kryesore politike e kishte lirinë dhe Republikën, ndërsa në vitin 1989 që të tre e bashkudhëheqin Konferencën e Parë të Lëvizjes në nivel kombëtar, të mbajtur në Divjakë të Malishevës, prandaj i mungonte çdonjëra nga këto kushte të domosdoshme për kryerjen e detyrës së diplomatit.

Vrasja më 30 maj 1989 në demonstratë e bashkëveprimtarit të tij, heroit Ali Ajeti; rënia heroike e Afrim Zhitisë së bashku me Fahri Fazliun më 2 nëntor të vitit 1989 si dhe vdekja e Fadil Vatës më 25 prill 1990 në Spitalin e Baselit, këto janë disa nga zhvillimet politike, të sjella në libër në formë kujtimesh nën titullin e përbashkët në vend të hyrjes, që i paraprijnë daljes së Sabri Këçmarit jashtë vendit, shkaku i rrezikimit pas t'u arrestuar nëse edhe më tej do të qëndronte i


fshehur në Kosovë, të cilat njëkohësisht e shënojnë edhe përmbylljen kronologjike të parahistorikut të përfaqësimit diplomatik mbi njëvjeçar të UÇK-së. Momentin kulminant të këtij parahistoriku e shënon pjesëmarrja e Këçmarit, sado që i ndodhur jashtë Kosovës, në debatet programore dhe vendimmarrëse në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme të Lëvizjes, të gushtit të vitit 1993, në të cilat, vlerëson autori, është vendosur dhe përcaktuar qartë domosdoshmëria e organizimit të luftës çlirimtare si dhe përcaktohen bazat themelore, teorike, politike dhe filozofike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Afër katër vjet më vonë, më 16 shkurt 1997, i dërguari nga Kosova, pjesëtari i Shtabit i Zonës Operative të Llapit të UÇK-së, Sejdi Rama, i ardhur në Gjermani me detyrë të veçanta nga komandanti Rrustem Mustafa-"Remi", shënon fillimin e veprimtarisë diplomatike të Këçmarit si përfaqësues i UÇK-së. Që në takimin e parë të karakterit diplomatik në Bon, më 4 mars 1998, me drejtorin politik të Ministrisë së Jashtme të RFGJ-së, Wolfgang Ischinger, Këçmarit e shpjegon mbështetjen që e gëzon UÇK-ja, prapa së cilës nuk qëndrojnë vetëm organizata të ndryshme politike atdhetare, por e drejta për pavarësi, si vullnet dhe e drejtë e qytetarëve të Kosovës.

Përfaqësimi politik i UÇK-së nga ana e Sabri Këçmarit, në fakt, zyrtarizohet më 24 shtator 1998, në takimin e tij me Bardhyl Mahmutin në Zvicër, nga i cili Këçmarit njoftohet me vendimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për t'i emëruar si përfaqësues për marrëdhënie me jashtë Sabri Këçmarin, Jashar Salihun, Bilall Sherifin, Ramadan Avdiun, Agush Bujën, Rexhë Ibërdemajn dhe Mujë Rugovën, ndërsa drejtues i grupit përfaqësues ishte emëruar Bardhyl Mahmuti. Në të njëjtën ditë, të tre përfaqësuesit diplomatikë të UÇK-së, Bardhyl Mahmuti, Sabri Këçmarit dhe Ramadan Avdiu, e realizojnë konferencën e parë për media në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, ku marrin pjesë rreth 30 gazetarë të medimeve të ndryshme ndërkombëtare.

Me vendimin e Shtabit të Përgjithshëm, anëtarët e grupit njoftohen edhe nga Hashim Thaçi, shef i Drejtorisë Politike të UÇK-së, një javë më vonë, më 1 tetor 1998, në takimin që do ta kenë me të, ku ishin të pranishëm Jashar Salihu, Bardhyl Mahmuti, Bilall Sherifi dhe Mujë Rugova.

Që nga konferenca e parë për media në Gjenevë, përfaqësimi diplomatik i UÇK-së zhvillohet në dy rrafshje: në rrafshin medial, përmes konferencave, intervistave, deklaratave, reagimeve në media, që njihet si diplomaci publike, dhe atë të diplomacisë klasike, përmes takimeve me ministra e zëvendësministra të jashtëm shtetesh, diplomatë, atashë ushtarakë, me kryeprokuroren e Tribunalit të Hagës,



Louis Arbour, në Parlamentin Evropian dhe atë të Belgjikës. Intervista e parë e Këçmarit në cilësinë e përfaqësuesit të UÇK-së, e dhënë për gazetën gjermane "Der Spiegel", realizohet më datën 12 tetor 1998. Kjo intervistë pasohet nga një mori intervistash, deklaratash e reagimesh të tjera të autorit për gazetat "The Guardian", "Birmingham Pot", "Die Presse", "Süddeutsche Zeitung", "Reformatisch Dagblat", "Hürriet Daily", "Der Standard", "Facts", "Tageszeitung", "Saarbrücker Zeitung", radiot "Radio Berlin", "Radio Austrinë", televizionin "NTV", "ZDF", "Deutschlandfunk", kurse konferenca për media, pas Gjenevës, mbahen edhe në Bruksel, Bon e Vjenë.

Nga lënda e librit vërehet se kontaktet me mediat ashtu dhe ato me përfaqësues politikë apo ushtarakë shtetesh, përfaqësimin e UÇK-së nga ana e Sabri Këçmarit, Bardhyl Mahmutit, Jashar Salihut dhe pjesëtarëve të tjerë të grupit diplomatik, i cilëson paraqitja shumë e kujdesshme, duke përfshirë edhe veshjen dhe zotërimin e rrjedhshëm të gjuhëve gjermane, franceze dhe angleze, përgatitja në shkallë të lartë, me të dhëna dhe faktografi konkrete, durimi argumentues i së drejtës së Kosovës për t'u çliruar përmes luftës së armatosur të UÇK-së si një luftë e imponuar nga shtypja dhe dhuna e Serbisë dhe këmbëngulësia për ta fituar besueshmërinë për hyrje në raporte serioze diplomatike dhe mbështetjen evropiane të luftës çlirimtare të Kosovës përmes kalimit të sprovave të kooperimit, dëshimit praktik të organizimit strukturor dhe përgjegjshmërisë si parakushte të domosdoshme.

Bazuar në të dhënat e librit, përfaqësimi diplomatik i UÇK-së kalon nëpër faza të ndryshme, të dallueshme nga njëra tjetra, varësisht nga fazat e zhvillimit të UÇK-së, përkatësisht luftës në Kosovë. Përdorimi në fazën fillestare, nga Këçmarit dhe përfaqësuesit e tjerë diplomatikë të UÇK-së i gjithë angazhimi zhvillohej në drejtim të shpjegimit dhe bindjes së faktorit ndërkombëtar, se UÇK-ja ishte një ushtri me strukturë dhe hierarki të qartë drejtuese politike dhe ushtarake; se lufta e saj ishte e pandikueshme dhe nuk kishte asgjë të përbashkët me qarqe dhe bindje ideologjike, regionale dhe religjioze, propagandë kjo që po përhapej nga qarqe mediale dhe

diplomatike të Serbisë; prezantimin e krimeve serbe kundër civilëve shqiptarë; argumentimin e shkeljeve nga ana e Serbisë të rezolutave të ndryshme që ishin në fuqi; argumentimin se mërgimtarët po i përgjigjeshin vullnetarisht luftës dhe se nuk po ndodhte mobilizimi i dhunshëm i tyre, në periudhën e pas marrëveshjes së Rambujesë, përkatësisht në kohën e fushatës ajrore të forcave të NATO-s kundër Serbisë, që shënon edhe fazën vendimtare të luftës së Kosovës, në qendër të përfaqësimit ishin njoftimi i dokumentuar i opinionit publik, politik, diplomatik e ushtarak ndërkombëtar me gjenocidin që po zhvillohej kundër shqiptarëve në Kosovë si dhe argumentimi i shtruar i humbjes së vlefshmërisë së marrëveshjes së Rambujesë në raport me statusin e ardhshëm të Kosovës dhe vetë UÇK-së, duke e mbrojtur në këtë rast qëndrimin se zgjidhja e statusit duhet kërkuar përmes referendumit, rezultati i të cilit me siguri se do të ishte pavarësia e Kosovës, ndërsa UÇK-ja nuk duhej shpërbërë, por transformuar në ushtri të Kosovës. Janë gazetarët e shumtë gjermanë ata që nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë, më 18 mars 1999, nga ana e delegacionit të Kosovës, e cilësojnë si "fitore diplomatike të UÇK-së" me rastin e ftesave të shumta dhe urimit që i bëjnë diplomatit të UÇK-së, Sabri Këçmarit, i cili marrëveshjen e vlerëson si rreshtim të Kosovës për herë të parë publikisht dhe përmbajtësisht me Përdimin dhe, si të tillë, e quan fitore të madhe. Duke qenë hera e parë kur në libër flitet për fitoren diplomatike, konsideroj se edhe titulli i librit e ka prejardhjen pikërisht tek akti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Rezultatet e para, të prekshme, të nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë, shfaqen gjashtë ditë më vonë, më 24 mars 1999, kur fillojnë bombardimet ajrore të NATO-s kundër Serbisë, kurse bombardimi i NATO-s mbi Beograd konsiderohet nga autori i librit si forma më e dukshme e fitores diplomatike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjithë Kosovës.

Sjellja e herëpashershme nga ana e autorit e kujtimeve nga përjetimet dhe emocionet e veçanta të çastit pas rënies së bashkëveprimtarëve Ali Ajeti, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu, Fehmi Lladrovci dhe Xhemajl Fetahaj, nxjerrë në sipërfaqe

segmente të pasura, fisnike, të anës personale njerëzore të autorit, ia shton vlerat e përgjithshme librit, posaçërisht ato historiografike, ndërsa lexuesin, posaçërisht atë të generatës së pasluftës, e ndihmon për t'i njohur më mirë këta heronj të Kosovës.

Është në interes të lexuesit, në kuptimin e njohjes së tij me një aspekt tjetër të luftës në Kosovë, në këtë rast mungesës së unifikimit politik ndërshtetëror, bërja publike e skenave groteske si ajo në Komisionin Evropian, e datës 10 nëntor 1998, ku në vend se të ulen së bashku, delegacioni i LDK-së dhe ai i UÇK-së ulen përballë njëri-tjetrit dhe, përdorin përfaqësuesit e UÇK-së, Bardhyl Mahmuti e Sabri Këçmarit, shtrajnë nevojën për ndihmë UÇK-së dhe për ndërhyrje të Komisionit Evropian për ta evituar katastrofën humanitare në Kosovë, përfaqësuesit e LDK-së kërkojnë ndihmë për arsimin. Groteskat e tilla janë, po ashtu, një lëndë e çmueshme në interes të analizave dhe trajtimeve të ndryshme shkencore: historike, politologjike dhe sociologjike.

Kthimi i diplomatit Këçmarit më 21 qershor 1999 në Kosovën e çliruar, i sjellë në libër përmes një simbolike të fuqishme siç paraqet hyrja përmes qytetit të Lidhjes, Prizrenit, marshimi i togës së ushtarëve të UÇK-së në një rrugë të këtij qyteti, ideja për ta vizituar më të mbërritur në Prishtinë së pari të zotin e shtëpisë në Kosovë, Bacën Adem Demaçi, i cili në gushtin e vitit 1998 ishte emëruar Përfaqësues i Përgjithshëm i UÇK-së, shkuarja në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, nga e cila, siç njoftohet më 5 prill 1999 nga RTSh-ja, Sabri Këçmarit ishte emëruar përfaqësues diplomatik në Austri, kurse Bardhyl Mahmuti në Francë, Jashar Salihu në Zvicër, Pleurat Sejdiu në Britani të Madhe, Mujë Rugova në Gjermani dhe Dino Hasanaj në ShBA, takimi i tij me kryeministrin Thaçi dhe ministra të shumtë dhe përmbyllja e ditës së hyrjes me qëndrimin në Komandën e Zonës Operative të Llapit, takimi aty me komandant Rrustem Mustafën-Remin, Çelin, Doktorin, Latën, Dajën dhe, kulminacioni, takimi me Sejden, Sejdi Ramën e takimit të 16 shkurtit 1997 në Gjermani, është kryekëput në funksion të bërjes sa më të prekshme për lexuesit të fitores diplomatike, njëkohësisht dhe "happyndit", edhe letrar, të kësaj fitoreje të UÇK-së dhe Kosovës.

Libri "Fitorja diplomatike" është një libër i rrallë, që pasqyron një pjesë të angazhimit të autorit dhe përfaqësuesve të tjerë diplomatikë të UÇK-së në Evropë në mbështetje të UÇK-së dhe luftës së saj për lirinë e Kosovës dhe, si i tillë, paraqet një angazhim të veshëm shkencor të diplomatit Këçmarit në shkrimin dhe publikimin e historikut të diplomacisë së UÇK-së si pjesë e rëndësishme e historikut të përgjithshëm të saj, të përpjekjeve dhe luftës së Kosovës për liri.

Vigani i studimeve të gjuhës e të historisë kombëtare

Formimi i gjerë lingvistik që prof. Ajeti e mori në qendra të mëdha dhe me traditë të gjatë universitare si në Zagreb, në Romë etj. i krijoi kapital të pasur teorik që të merrej me kompetencë me hulumtime shkencore-gjuhësore albanologjike e ballkanologjike, të cilat do të kurorëzohen me vepra shumë të çmueshme dhe me vlerë të përherëshme shkencore



Hasan MUJAJ

Trembëdhjetë shkurt dy mijë e nëntëmbëdhjetë. U nda nga jeta akademik Idriz Ajeti, intelektual i formatit sipëror me erudicion njëzues shkencor e arsimor, studiuesi i spikatur i gjuhësisë shqiptare e ballkanike. Por, u nda nga jeta vetëm fizikisht sepse emri i tij zulummadh do të jetë prurë i pranishëm dhe i cituar në studimet albanologjike dhe në historinë e kulturës sonë kombëtare.

Nëse Shkolla Linguistike e Gjenezës njihet nga themeluesi i gjuhësisë moderne evropiane dhe i semi-otikës Ferdinand de Sosyri; nëse Shkolla Linguistike e Kopenhagës, e njohur me emërtimin glosematikë, identifikohet me themeluesin e drejtuesin e saj Luis Hjelmslevin; nëse Shkolla Linguistike e Pragës njihet nga "babai" i saj Nikola Trubeckoi; po qe se studimet e albanistikës të Shkollës Linguistike të Tiranës identifikohen me emrin e indoeuropeistit dhe ballkanologut zëmadh prof. dr. Eqrem Çabej, prijës dhe drejtues me kompetencë të lartë shkencore i Shkollës Albanologjike të Prishtinës për vite të tëra qe dhe mbeti edhe sot e gjithë ditën prof. dr. Idriz Ajeti, njëri nga studiuesit më të merituar dhe lingvistikisht më të formuar të shkencave të gjuhësisë shqiptare dhe ballkanike.

Në sintagmat e sipërthëna leksema "shkollë", e përdorur në tejbartje konotative, nënkupton një drejtim, një formacion të tërë lingvistik, i cili karakterizohet nga arritjet e mëdha shkencore ashtu siç nënkupton edhe një vatrë të afirmuar arsimore-shkencore, nga e cila po ngrihen e do të ngrihen edhe në të ardhmen dijetarë të rinj të studimeve të filologjisë moderne. Pikërisht nga kjo vatrë dijeje rrodhi ndriçimi i shkëndijave diturore, arsimore e shkencore të prof. Ajetit të ekzekutuara përmes qindra ligjëratave, kumtesave, referateve, koreferateve si dhe shumë botimeve të veçanta, të cilat ravijëzuan hulli të reja arritjesh shkencore të gjuhësisë shqiptare.

Shkolla albanologjike e Prishtinës, e prirë nga prof. Idriz Ajeti, i tejkaloi caqet kombëtare dhe, sidomos përmes Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, për themelimin e të cilit prof. I. Ajeti qe njëri nga më të merituarit, u afirmua edhe në qendrat më të njohura të studimeve të filologjisë ndërkombëtare. Ajo i dha

shtytë të re nxitëse shtrirjes së gjerë të interesimit të studiuesve të huaj jo vetëm për gjuhën e letërsinë shqipe, por edhe për historinë, arsimin, artin dhe vlerat e tjera të kulturës shqiptare.

Në këtë mënyrë ky Seminar, i drejtuar vite me radhë nga prof. Ajeti, krijoi një pasqyrë të ndritur objektive rreth prestigjit nacional (shqiptar) në relacionet ndërkombëtare në pikëpamjen diakronike dhe sinkronike.

Kontributi i prof. I. Ajetit shtrihet në shumë fusha të dijes nga të cilat dy janë mbizotëruese: 1. fusha e kërkimeve shkencore-lingvistike dhe 2. fusha e arsimit dhe e ngritjes së institucioneve shkencore në Kosovë.

1. Kërkimet shkencore-gjuhësore

Formimi i gjerë lingvistik që prof. Ajeti e mori në qendra të mëdha dhe me traditë të gjatë universitare si në Zagreb, në Romë etj. i krijoi kapital të pasur teorik që të merrej me kompetencë me hulumtime shkencore-gjuhësore albanologjike e ballkanologjike, të cilat do të kurorëzohen me vepra shumë të çmueshme dhe me vlerë të përherëshme shkencore. Disa nga veprat e këtyra të prof. Ajetit janë: Historia e gjuhës shqipe, Kërkime gjuhësore, Studime gjuhësore I, II, III, IV, Studime gjuhësore në fushë të shqipes, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Zhvillimi historik i së folmes geqe të arbëreshëve të Zarës etj.

Interesimi i prof. Ajetit për kërkimet shkencore gjuhësore është shumë i gjerë. Kështu ai u mor: me çështje të drejtshkrimit të shqipes, me kulturën e gjuhës, me çështjen e kalkeve gjuhësore, sidomos nga serbokroatishtja në shqipen, me purizmin gjuhësor, me historinë e gjuhës, me studimin e dialekteve të shqipes, me leksikologjinë, me onomastikën, me standardizimin e gjuhës shqipe etj. Me rëndësi të veçantë është kontributi shumë i madh i prof. Ajetit në fushën e kërkimeve të transferencave e të interferencave të ndërsjella gjuhësore të shqipes me gjuhët sllavojugore, sidomos me serbokroatishten.

Studiuesi i njohur i problematikës së ndërkombëtare gjuhësore të shqipes dhe të serbokroatishtes, prof. Murat Blaku tumir mendimin e prof. E. Çabej sipas të cilit "I. Ajeti është sot pa dyshim një ndër njohësit dhe studiuesit më të shquar të marrëdhënieve gjuhësore ndërmjet shqipes dhe gjuhëve sllavojugore. Ka kohë që ai ka krijuar në këtë fushë kërkimesh një individualitet të formuar e sovran me autoritet të njohur e të formuar shkencor" (E. Çabej, Studime gjuhësore VII, Prishtinë, 1986, f. 182). Siç shihet edhe nga konstatimi i

sjellë, njohuritë e gjera dhe të thella shkencore të prof. I. Ajetit rreth bashkëtakimeve dhe ndërkombëtare të shqipes me gjuhët sllavojugore u vlerësuan shumë lart nga studiues të spikatur albanologjicë e ballkanologjicë si p.sh.: Eqrem Çabej, Murat Blaku, Latif Mulaku, Hilmi Agani, Besim Bokshi, Rexhep Ismajli, Mahir Domi etj. Njohës i thellë jo vetëm i dukurive historike, fonetike, morfologjike, dialektore etj., por edhe i faktorëve sociolinguistikë dhe jashtëgjuhësorë si p.sh.: etnologjikë, sociokulturorë, politikë etj. prof. Ajeti, nga drita e të dhënave shkencore, vuri re dhe hodhi poshtë pretendimet pseudoshkencore të disa autorëve sllavë si p.sh. të Selishçevit e të ndonjë tjetri (I. Ajeti, Studije iz istorije albanskog jezika, Prishtina, 1982, s. 9) sipas të cilave nuk mund të flitet për ndikimin e shqipes në gjuhët sllave me të cilat gjuha shqipe ishte në kontakt.



Mendimi i prof. Ajetit, i mbështetur në të dhënat lingvistike, onomastike e historike, por edhe në shkencat e tjera si dhe në faktorët sociokulturorë përkritazi me rolin dhënë të shqipes, është pranuar edhe nga studiues shumë të njohur dhe të afirmuar të gjuhësisë ballkanike dhe indoeuropiane jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj si p. sh.: Herik Bariçi, Petar Skoku, Ivan Popoviçi etj., të cilët gjetën shumë fjalë të shqipes në serbokroatishte, bullgarishte e maqedonishte. (Murat Blaku, Ndikimi i shqipes mbi të folmet serbe të Kosovës, Prishtinë, 2010, f. 27-28.)

Duke e ndjekur më tej këtë fushë studimi me objektivitet dhe me kompetencë të bazuar shkencore, vetëm në Fjalorin e Glisha Elezoviçit (Aty, f. 34) prof. Ajeti gjeti rreth treqind fjalë e shprehje të shqipes. Praninë e albanizimeve në të folmet serbe të Kosovës si dhe në të folmet maqedonase në Maqedoni e kishte parë dhe dëshmuar me të dhëna burimore edhe studiuesi Ivan Popoviçi, sipas të cilit mund të gjendet një pasuri leksikore prej rreth një mijë fjalësh.

Edhe prof. E. Çabej me të drejtë e kishte vënë re mbëhinë e hulumtimit të ndikimit të shqipes në gjuhët sllave me të cilat ishte në kontakt. Ai vlerësonte se kjo problematikë meritonte vëmendjen e studiuesve si një fushë e parratur sa duhet dhe me interes shkencor. Sipas Çabej, ndërlihdja e shqipes me gjuhët në simbiozë, duhej të ndiqej nga dy pikëpamje: 1. transferencat gjuhësore të gjuhëve fqinje në shqipen dhe 2. depërtimi i njësisë gjuhësore

të shqipes në këto gjuhë.

Madje Çabej konsideronte se pikëpamja e dytë shënonte një kundrim të ri, i cili nuk ishte i njohur sa duhej në shkencën e gjuhësisë dhe, nëse nuk hulumtohet roli dhënë i shqipes, Çabej do të shkruajë: "...një histori e gjuhës shqipe do të dilte mjaft e njëanshme..." (E. Çabej, Studime gjuhësore, III, Prishtinë, 1976, f. 71) sepse është e pamundshme që, gjuhët në kontakt me shqipen, të mos kenë pësuar ndikim nga njëra nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit siç është shqipja. Por, është e kuptueshme se kjo vërtetësi nuk mund të tumirej nga disa qarqe pseudoshkencore që, për arsye politike, mohonin shqipen si gjuhë të vjetër dhe prejardhjen ilire të saj, kurse sa për ndikimin e shqipes në gjuhët fqinje, sipas këtyre burimeve shkencërisht inekzistente, as që mund të shtrohej diskutimi. Hulumtimet dhe arritjet shkencore të prof. Ajetit dhe të disa studiuesve të tjerë rreth temës në trajtim dëshmuar të kundërtën: shumë fjalë, shprehje frazeologjike, urime etj. të shqipes kanë hyrë në gjuhët në kontakt me shqipen.

Do vënë në dukje se ndikimi i kulturës shqiptare te popujt e tjerë është parë edhe në fusha dhe në veprimtari të tjera si: në folklor, në etnografi, në besimet popullore, në rite të ndryshme, në veshjet popullore etj. Akademik I. Ajeti është pjesëmarrës me kumtesa, referate e koreferate në një numër të madh sesionesh, simpoziumesh dhe konferencash shkencore të nivelit kombëtar e ndërkombëtar që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme të gjuhësisë shqiptare, shumë nga të cilat u mbajtën nën përkujdesjen dhe drejtimin e prof. Ajetit.

2. Në krye të institucioneve më të larta shkencore e politike

Me kapital të gjerë kognitiv të zhvillimeve arsimore e shkencore të kohës, studiues me bazë të gjerë diturore i disiplinave të ndryshme të lingvistikës, vështirë i përsëdytshëm deri më sot, s'është habi që I. Ajetit do t'i takojë merita që vite të tëra të gjendet në ballë të institucioneve më të larta shkencore e arsimore të Kosovës si p.sh.: dekan i Fakultetit Filozofik të Prishtinës, rektor i Universitetit të Prishtinës, drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, kryetar i Kuvendit të Kosovës etj. Në të gjitha këto vende drejtuese u dallua me rezultate të mëdha shkencore dhe e avancoi zhvillimin e shkencave të gjuhësisë shqiptare.

Në vitet e tetëdhjeta dhe në vijimësi më pas, kur nga Akademia e Shkencave e Serbisë, në mënyrë të organizuar, dolën në skenë të hapur tendencat pseudoshkencore e antishqiptare që mohonin historinë burimore, gjuhën e kulturën shqiptare, akademik I. Ajeti, si përmes shkrimesh, ashtu edhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në takimet e ndryshme shkencore, me

forcën e argumenteve të pamohueshme shkencore, i doli zot prejardhjes ilire të shqiptarëve dhe burimit të gjuhës shqipe nga ilirishnja.

Konstatimet e këtyra i pasqyroi edhe në një konferencë "shkencore" në Beograd nga fundi i viteve të tetëdhjeta që më shumë ishte politike e në të cilën trajtohej çështja e Kosovës me ç'rast, një politikan serb tha: "Duhet të jesh specialist i lingvistikës që ta kuptosh referimin e Idriz Ajetit".

Qe dhe mbeti themelvënës i krijimit dhe i zhvillimit të studimeve të albanistikës në Kosovë e më gjerë, i shquar nga akribia shkencore kognitive e kompetitive, e cila i siguroi vend të përherëshëm nderi në elitën e shkencëtarëve më të ndritur arritjesh risimtare.

Kundruar nga kjo pikëpamje, për kompetencën e lartë shkencore-gjuhësore të prof. Ajetit, vlen të spikatet posaçërisht një fakt: vështirë të rastisë, shumë vështirë të gjendet ndonjë studiues që, në moshën njëqindvjeçare, do të jetë në gjendje të hartojë tekst metaforik të një ekspresiviteti stilistikisht kaq të lartë, semantikisht kaq domethënës dhe estetikisht aq mbresues e përjetues. Si dëshmi të këtij konstatimi, po sjell disa fjali të prof. Ajetit, të cilat i referohen gjuhës shqipe në fjalimin e shënimit të njëqindvjetorit të lindjes së tij (më 27 janar 2017). "... e nisa pikërisht me gjuhën shqipe, dashuri imja e pashterur, e pashuar dhe e përjetshme".

"... sa i pafund është thesari i saj. Sa e pafund ka qenë ideja për ta bërë një-të përbashkët, të plotë".

"... me idenë për të gjetur copëzat e shpërndara dhe për t'i bërë bashkë ato...".


Sikundër mund të shihet, akademik Ajeti përdori një stil të përmbledhur: fjali të shkurtra nga ndërtimi, por të gjata, shumë të gjata nga kuptimi, stil shkencor të veshur me art.

Ideja "për t'i gjetur copëzat e shpërndara (d.m.th. të gjuhës shqipe) dhe për t'i bërë bashkë ato, siç e tha studiuesi ynë, qe ideal gjithëkombëtar i shumë e shumë studiuesve, krijuesve e veprimtarëve të mëdhenj që u flijuan për sendëtimin e programit nacional të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në të cilin gjuha shqipe qëndronte në krye të vendit. Zhvillimin e mëtejshëm të këtij programi e ndoqi dhe e shpuri përpara edhe prof. Ajeti.

Implikatura e këtij citati metaforik ngre lart stilin e autorit, artëson e fuqizon gjuhëzimin e mendimit; ajo nënkupton se një ditë edhe pjesët e kombit, detyrimisht të ndara, do të bëhen bashkë ashtu siç u bë gjuha shqipe. Përpjekjet e vazhdueshme për ta bërë një (gjuhë) të përbashkët qenë përkushtim jetësor i prof. Ajetit dhe i shumë albanologëve e studiuesve të tjerë.

Akademik Ajeti la pas edhe thënie prej mendimtari të thellë me vlerë të përherëshme domethënëse si p. sh.: "Përparimi ynë si shtet bazohet në dije, shkencë e arsim..." "Shteti i Kosovës ndërtohet me vizion dhe me durim".

Gjuha shqipe do të pasurohet, por "pa e trandur themelin e saj". E të tjera.



Autor: GAZMEND MORINA	MJET KOMUNIKIMI (shq.)	METAFORË E GJATË	SUPER MODELJA BRAZILIANE ADRIANA	PARA TË NËNTËS	KËNGA E POPULLARIZUAR QYTET NË SHQIPËRI
FILOZOF NË GREQINË E LASHTË (shq.)					
PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)					
FRIKË E MADHE					
					LLOJ DRURI
PËRFAQËSI DIPLOMATIKE MË E ULËT SE AMBASADA (hist.) FONI ALBA			AKTORJA ... FRIEL LLOJI I NJË PRODHIMI SIPAS FORMËS E MADHËSISË		
KËNGËTARJA RITA ...				DITMAR HAMAN SIPËR	
INICIATIVA					QYMEZ ELEMENT KIMIK (SE)

SUDOKU								
1			6		9			4
	8							1
	9	2	7		5			3
		4		2	6			5
6								9
		7	8				4	
	4		3		1	5	8	
5								9
	7		5	4				3

EPOKA E RE	ISH KËNGËTARI AMERIKAN NË FOTO	TUPAN	SHTET NË EVROPE	SCREEN ACTORS GUILD	ZANORE	ZANORE KËNGËTARJA ... ISTREFI	OSMAN BAJRAMI KUDRET ISAI		LLOJ PIJE E NXEHTË E ORIENTALE (shq.) SHITRESË										
PUBLICISTI SHQIPTAR YPI							DISIPLINË SPORTIVE KA A DEM I PATREDHUR (shq.)						NAIM ISMAJLI SHASTISEM					KRYEQYTETI I JORDANISË	
NJOLLA					PEZMATIM I VESHIT REGJISORI ... SOPI				ISH FUTBOLLISTI SHEARER (orgj.) LUMË NË AFRIKË				RESHAT ARBANA SHOSHITET						
E NDYRË, BANALE AKTORJA & MODELJA JOVOVICH							KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIKË ISMET PEJA												ZANORE SHKENCA QË MERRRET ME KRIJIMIN E MALEVE
				PJESËMARRJA NË NJË GARË DHËMBOR															
DIÇKA LËNDORE KONKRETE E BOTËS JO TË GJALLË; GJË (shq.)						THIRRJA QË I BËHET MASËS AI ME TË CILIN QUHEMI													ELEMENT KIMIK (NT) "RIADI"
BASHKËT.		GJOJA, KINSE GODINA MBI LUMË					BASHKËT. NDALIMI		GRYKA E VULLKANIT NËNË (turq.)										
MBRON DIÇKA NGA DIKUSH					FUTBOLLISTI SULLEY (MILAN) SHKEL E SHKO, RRËMUJË								FUTBOLLISTI SAMUEL ... LLOJ PAPANAGALLI					VETI E ATLJ QË ËSHTË TRIM	
ISMET RAMUSHI			TANTAL, REOMIR BIMË QË PËRDORET PËR TË MBULUAR ÇATITË (shq.)				LETRARI MEHMETI (shq.) KËNGËTARJA NJOMZA						AZEM MAKSUTAJ LUMË NË KOSOVË				DY BASHKËTINGËLLORE PAJTUESHMËRI (krah.)		
LËNDË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL									KUNDËRSHTAR I BOLSHEVIZMIT RUS ZANORE					"E" në mes të dy "R" GROSETO, ATALANTA					
BASHKËT.		ALUMIN, AMPËR ARRATISUR				KËNGËTARJA ... FARA ELIZABETH BANKS			STUHIA E FORTË ME ERË DHE SHI ZANORE										
"LL" pas dy "I"				USHQIM QË SHTROHET E HAHEG GJATË PIJES NATRIUM, TON					"EPOKA ... " KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK				SHKRIMTARI SHKRELI ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER						
EPOKA E RE	LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.) DY BASHKËTINGËLLORE								KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA ARTIOLA TOSKA					LEJE PËR TË SHKUAR NGA ODA EDITA SOPJANI					
BIXHOZ						KËNGËTARJA VALENTINA BASHKËT.					VEJAN ZANORE						ANA RUSO ISLANDA		
EMËR YNI DJALI (shq.)							BANORI I ATIKËS											ZANORE	

ZGJIDHJA E FJALËKRËQIT: TALESI, ELIAT, LEMERI, LEGATA, FO, ANA, ORA, DM, NISMA, KOTEC, I, OB, SALEPI, EDISON, KRIBET, NI, LARA, OTIT, ALAN, RA, VULGARË, INTERESIM, MILLA, GARIMI, NIMI, A, SENDI, APELLI, NITON, P, DEMEK, N, KRATERI, RUAN, MUNTARI, ETO, IR, TAR, DINI, AM, GJT, SAKARINA, ESER, RER, LL, ALA, ELI, URAQANI, ILLI, MEZE, ERE, AZEM, KANABISI, INA, IZE, KUMAR, RAMA, I VE, AR, DRITANI, ATIKASI, I. ZGJIDHJA E SUDOKUT: KOJONA I: 135 689 742; KII: 768 432 951; KIII: 492 715 638; KIV: 314 926 875; KV: 658 147 329; KVI: 927 853 416; KVII: 249 361 587; KVIII: 563 278 194; KIX: 871 594 263.

Një dashuri si e Zheni Marks

Në moshën 18-të vjeçare, Xheni baronesha fon Vestfalen ishte sublime. Vajza me sytë e bukur e Tririt, zeshkane, kryelartë me sytë gjelbër, me fytyrë të përsosur, vezake ishte aq tërheqëse. Poeti Hajnirih Hajne, kur e takoi në Paris tha: Ajo është magjike. Dhe të gjithë ata që e shihnin bashkë me Marks in do të shpreheshin në këtë mënyrë. Dashuria e saj me Marks in lindi që kur ishin adoleshentë por asnjëherë nuk ia shprehën njëri tjetrit. Gjithçka do të ndryshojë pas kthimit të Karlit nga Boni ku kishte shkuar për të studiuar.

Xheni në atë kohë ishte njëzet e dy vjeçe. Karli shkoi për ta takuar në shtëpinë e saj në Vestfalen dhe e ftoi të shëtisnin në fushë. Tashmë ata nuk ishin më dy fëmijë por dy të rritur që shihnin gjëra të tjera tek njëri tjetri. Pikërisht në atë shëtitje ai do të shprehte dashurinë.

Por mosha e tyre e re nuk do të mirëpretej nga familja e Zhenit. Kjo do të bënte që çifti ta mbante të fshehtë dashurinë për disa vite, e të takoheshin në fshehtësi. "Ah! Zemra ime e dashur, sa e rëndë është peshja që e gjitha ajo që ka ndodhur ka hedhur mbi shpirtin tim! E megjithatë, Karli! Nuk provoj, nuk mund të provoj asnjë brerje ndërgjegjeje.

Mbyll sytë dhe shoh vështrimin tënd të lumtur. E di fare mirë atë që kam bërë, edhe sikur kjo të më



bëjë të padenjë dhe të më ngjallë dënimin publik. E di dhe sërish jam në gëzim dhe nuk do ta ndërroja me asnjë thesar në botë kujtimin e atyre orëve. Oh! Karli, jam e keqe. Tek unë nuk ka asgjë të mirë përveçse dashurisë për ty... Fundi i dashurisë tënde, do të jetë po atë minutë fundi i ekzistencës sime. Dhe pas kësaj vdekjeje nuk ka ringjalljeje." Kjo letër e shkruar pas një takimi të fshehtë, tregon qartë se Zheni është e gjitha e dashuruar dhe e pushtuar

nga frika se mos e humbur Karlin. Ndoshta po të ndodhte kjo ajo do të vriste veten. E pas martesës e sfidave të një jete në kërkim, dy bashkëshortët nuk do të harronin të komunikonin gjithnjë përmes letrave me njëri tjetrin.

"Mund t'u siguroj pa asnjë romantizëm se jam i dashuruar nga koka tek këmbët dhe se kjo është shumë serioze", shkruan ai në një letër. Zheni do të jetë gjithnjë lexuesja e tij e parë. Është ajo

që do të kopjojë e rikopjojë gjithmonë faqe më faqe të gjitha dorëshkrimet e tij para se të nisen në shtyp.

Bashkë me Engëlsin ajo është e vetmja që ka përpirë çdo shkrim të tijin. Ajo ishte e bukur, shumë e bukur. E zgjuar, kryelartë. Atë të gjithë e quanin "magjike". Por ajo ishte gjithashtu gruaja e "djallit". Zheni dhe Karl Marks qëndruan të martuar tridhjetë e tetë vjet. Një lidhje e habitshme, lidhja e një aristokrateje prusiane dhe një

revolucionari të mbetur pa të holla.

Ata jetuan një histori të vërtetë dashurie. Të një lloji të tmerrshëm. Atë që e lidh një grua me një burrë gjeni. Së bashku ata njohën gjithçka: jetën prej bohemie ekzaltim evolucionar, urinë, përndjekjet policore, emigrimin... Nëse Zheni që e dashuruar ajo që gjithashtu e tradhtuar dhe derdhi lot të hidhur kur në vitin 1851 shërbëtorja e tyre lindi një fëmijë të Karlit. /Gazeta Shqip

Shkrimtari i njohur rrëfen takimin me Geishën që e frymëzoi

Artur Golden shkrimtari i librit "Kujtimet e një geishe", ka treguar se historia e këtij libri që edhe është ekranizuar, është frymëzuar nga një histori e vërtetë e Nita Sajurit. Në vitin 1956 ajo emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për vitet e fundit të jetës që i mbetën ajo ishte banuese në kullat "Valdorf" në qytetin e Nju Jorkut, ku në katin e tridhjetë e dy ndërtoi një suitë elegante të stilit japonez.

Edhe atëherë jeta e saj vazhdoi po me atë rrjedhë të rrëmbeshme. Suita e saj u shëndrrua në një vend takimi për artistët japonezë, intelektualë, biznesmenë të dëgjuar, madje edhe ministra kabinetesh. Në vitin 1985 një miku i tij e njohur Artur Goldenin me të. Miqësia e tyre erdhi duke u forcuar. Një ditë ai e pyeti nëse do të lejonte ndonjëherë që historia e saj të bëhej publike. "Vetëm nëse do të jeni ju që do e tregoni", iu përgjigj ajo.

Kështu nisi të shkruhej historia e këtij libri të njohur. Sauri dëshironte ti diktonte vetë kujtimet e saj në vend që ti shkruante vetë, sepse sic tregonte ishte kaq e



mësuar të fliste me një bashkëbisedues a do ta kishte të vështirë të mbyllej e të punonte në një dhomë ku askush nuk e dëgjonte. "Kurrë më parë nuk e kisha vënë re se Sauri fliste me dialektin e Kiotos, ku geisha quhen geiko dhe kimonove nganjëherë u thonë bebe-po pastaj fillova të vrisja mendjen se si do ti jepja ato nuanca në përkthimin tim.

Megjithatë që në fillim e ndjeva se kisha humbur në botën e saj. Pothuajse tërë kohën me përjashtim të pak rasteve ne takoheshim në mbremje sepse si pas një zakoni shumë të hershëm kjo ishte koha kur mëndja e Sajurit ishte plot energji. Zakonisht i pëlqente të punonim në suitën e saj, por herë pas here linim të takoheshim dhe në dhomat private në një restorant japonez në

shëtitoren "Park" ku ajo ishte shumë e njohur.

Përgjithësisht punonim një ose dy orë. Megjithatë ne incizonim çdo fjalë, sekretarja e saj ishte gjithmonë e pranishme për të transkriptuar diktimin e Sajurit, një punë që e bënte me shumë besnikëri. Por Sajuri nuk foli kurrë me digt fonin apo me sekretaren. Ajo foli vetëm me mua", tregon Golden.

I vetmi kusht i këtij rrëfimi ishte që të botohej pas vdekjes së saj. Në rrëfim ajo ka mundur të fshehtë emrat e shumë burrave për shkak të etikës, por jo ndjesitë që ata lanë tek ajo. Historia e Sajurit është e njohur tashmë në të gjithë botën përmes ekranizimit të këtij libri. Është historia e një geishe përballë dashurisë për një burrë që e njohur herët, që në fëmijërinë e saj. /Gazeta Shqip

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LIVERPOOL - BAYERN

1

LYON - BARCELONA

2

QPR - WBA

GG3+

Flamurtari 'koriti' Prishtinën, Feronikeli merr pozitën e parë



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 18 SHKURT - Sezoni pranveror në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ka filluar me shumë befasi, pasi skuadra e Prishtinës ka pësuar humbje në stadiumin "Fadil Vokrri" dhe në këtë mënyrë e ka humbur pozitën e parë. Faktikisht skuadra kryeqytetase në këtë stadium ditë më parë është eliminuar edhe nga gara e Kupës, kurse të hënën ka pësuar humbje nga Flamurtari që shumicën e kohës luajti pa një lojtar. Në minutën e 23-të Ben Quansah u ndëshkua me karton të kuq, por kjo nuk e pengoi skuadrën kuqezi të shënojë pas tetë minutave nëpërmjet sulmuesit më të mirë në ligë, Alban Shillovës. Prishtina pati kontrollin e lojës, por në fund të pjesës së parë Egzon Krasniqi ndëshkohet për herë të dytë. Në pjesën e dytë Prishtina dominoi, por Mankenda, Jasharovski e Khalid nuk shfrytëzuan rastet që kishin dhe ndeshja përfundoi me rezultat 2-0. Pas kësaj humbje Prishtina bie në pozitën e dytë, kurse Flamurtari ngrihet në pozitën e gjashtë me 25 pikë. "Në 20 minutat e para të lojës patëm njëfarë epërsie me kundërshtarin, por mendoj se me daljen me karton të kuq lojtarët tanë patën një siguri në veten e tyre dhe pësimi i dy golave me 10 lojtarë na bënë të mendojmë shumë gjëra për të ardhmen. Jam shumë i dëshpëruar për këtë

humbje. Duhet të reagonim shumë më mirë në pjesën e dytë. Gjatë pjesës së parë duhet të ishim shumë më kolektivë në mënyrën e zgjidhjeve të rasteve për shënim", ka thënë pas ndeshjes Mirel Josa, trajneri i Prishtinës. Ndërsa trajneri i Flamurtarit, Arsim Thaqi, pas ndeshjes deklaroi: "Kjo fitore ka një rëndësi të veçantë, pasi kryetari na ka krijuar kushte të mira dhe kjo fitore i dedikohet kryetarit, i cili sot feston ditëlindjen. E kemi dhënë maksimumin dhe kjo fitore e ka vlerën e veçantë. Shpresojmë në rezultate të tilla edhe në ndeshjet e tjera". Humbjen e Prishtinës për mrekulli e shfrytëzoi skuadra e Feronikelit që e mposhti Lirinë në Prizren (0-2) dhe në këtë mënyrë e rrëmben pozitën e parë në elitë. Pas shtatë minutave lojë, Kastriot Rexha e shënon golin e parë për skuadrën mysafire, kurse dy minuta pa përfunduar pjesa e parë e ndeshjes, Rexha e dyfishoi epërsinë e "Niklit". Në pjesën e dytë, pavarësisht prej rasteve nga të dyja skuadrat, gola të tjerë nuk pati dhe ndeshja përfundoi 0-2. Feronikeli tash është në pozitën e parë me 42 pikë, kurse Liria është e dhjeta me 19 pikë të grumbulluara.

Drita fiton derbin ndaj Gjilanit

Kampionia aktuale e elitës, Drita, e ka fituar të shtunën derbin ndaj Gjilanit (3-1). Golat për Dritën i

shënuan Ardian Limani (8'), Kyrian Nwabueze (71') dhe Erion Vucaj (90'+4'), kurse golin e vetëm për Gjilanin e shënoi Fiton Hajdari (69'). Fitore para tifozëve të vet kanë shënuar edhe Ferizaj dhe Ballkani. Skuadra e Ferizajt e ka mposhtur Trepçën '89 me rezultat 2-0, me golat e shënuar nga Genc Hamiti (12' e 14'). Fitore me rezultat 2-0 ka shënuar edhe Ballkani në përbalje me Drenicën, me golat e shënuar nga Blend Baftiu (7') dhe Edvin Kuq (63').

IPKO SUPERLIGA

Flamurtari - Prishtina	2-0
Liria - Feronikeli	0-2
Drita - Gjilani	3-1
Ballkani - Drenica	2-0
Ferizaj - Trepça'89	2-0
KEK-u - Llapi	0-3

TABELA

1. Feronikeli	18	42 pikë
2. Prishtina	18	40
3. Llapi	18	38
4. Gjilani	18	27
5. Drita	18	26
6. Flamurtari	18	25
7. Drenica	18	24
8. Ballkani	18	24
9. Trepça '89	18	22
10. Liria	18	19
11. Ferizaj	18	18
12. KEK-u	18	1

Në xhiron e radhës takohen: Drenica-Ferizaj, Trepça '89-Drita, Prishtina-Liria, Feronikeli-Llapi, Ballkani-KEK-u, Gjilanin-Flamurtari.

SHKURT

Prishtina përforcohet me amerikanin Rodney Bullock

Z Mobile Prishtina, pas suksesit historik në FIBA Europe Cup, është përforcuar me Rodney Bullock, i cili luan në pozitën e alos. "Rodney Bullock Jr së fundmi ka luajtur në Ligën hungareze tek Alba Fehervar dhe në FIBA Europe Cup ka pasur një mesatare prej 10.8 pikëve për ndeshje, 4.5 kërcimeve dhe 1.4 asistimeve. Bullock është 24 vjeçar, i gjatë 203 cm", thuhet në njoftimin e klubit prishtinas.

Rikthehet Media Liga

Pas një pushimi dimëror, rikthehet edhe gara e Media Ligës në Kosovë. Ndeshjet e para për sezonin pranveror pritet të fillojnë të premten nga ora 17:00, kurse ndeshja e parë zhvillohet në mes të "D+" dhe "Media Works"-it. Ekipi kryesues dhe favorit për t'u shpallur kampion, "Epoka e re", ndeshjen e parë e zhvillon për këtë sezon ndaj ekipit të "Telegrafi"-it. Ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo në mes të "Gazeta Metro" dhe "Infokusi"-t.

Hajdari e fiton medaljen e argjendtë

Atleti Musa Hajdari ka fituar medaljen e argjendtë në kampionatin ballkanik të sallës për senior, të mbajtur këtë fundjavë në Stamboll të Turqisë. Hajdari fitoi medaljen në disiplinën 800 metra. Ai arriti në cak me kohë 1:49.31, vetëm 11 të qindtat larg normës evropiane. Hajdari është bursist olimpik për "Tokio 2020".

Liburni, fitues i Kupës në futsall

Liburni është fitues i Kupës së Kosovës në futsall. Skuadra gjakovare në ndeshjen finale, e cila u zhvillua në pallatin e sportit në kryeqytet, në praninë e mbi 500 tifozëve, e ka mposhtur Prishtinën 01, me rezultat 4-3. Ndeshja finale dhuroi një lojë shumë të mirë nga të dyja ekipet. Pjesa e parë u mbyll me rezultat të barabartë, 2-2, kurse në pjesën e dytë gjakovarët shënuan edhe dy gola të tjerë, kurse kryeqytetasit shënuan vetëm një gol dhe në fund Liburni e fitoi Kupën. Për Liburnin shënues ishin me nga dy gola Arbër Dobroshi dhe Halim Selmanaj, kurse për Prishtinën dy gola i shënoi Agon Ramadani dhe një tjetër Oso Gjinovciti.

"France Football": Zeneli, energjik, teknik dhe vullnetar

Revista prestigjioze javore me bazë në Paris, "France Football", e ka vlerësuar lart paraqitjen e Arbër Zenelit për Stade de Reims. Që prej mbërritjes së tij në Reims më 26 janar, 23-vjeçari ka luajtur 18 minuta kundër Olympic Marseille dhe 6 kundër Toulouses. Por, këtë fundjavë kundër Rennesit, trajneri David Guion e futi atë në lojë në minutën e 55-të në vend të Mathieu Cafaro. Zëvendësimi doli të ishte tejet i suksesshëm. Pak sekonda pasi u fut në lojë, Zeneli qëlloi shtyllën me një goditje të fuqishme nga rreth 30 metra largësi. Pak më vonë, ai bëri asistimin e parë në Ligën 1, duke ia përgatitur golin Oudinit në fitoren 2-0 të Reimsit. "Energjik, teknik dhe vullnetar, një futbollist që ishte në radarin e shumë klubeve evropiane, përfshirë Chelseat, ka bërë punë të mirë në kampionat. Dhe, natyrisht, ky është vetëm fillimi", shkruan "France Football" për Zenelin.

Federata e Gjmnastikës shpalli sportistët e vitit

PRISHTINË, 18 SHKURT - Federata e Gjmnastikës e Kosovës ka shpallur gjmnastet më të mirë për vitin 2018. Në bazë të rezultateve të dala nga komisioni, sportiste e vitit është

shpallur Bora Hoti, kurse në kategorinë pioniere Valëza Rama. Në kategorinë e juniorëve më e mira është shpallur Lisa Zeqiri, kurse tek seniorete epiteti i më të mirës i

ka takuar Fitore Rudarit. Tri gjmnastet e Klubit "Elita" nga Prishtina rrëmbyen medaljet në saje të rezultateve që arritën në garat e organizuara përgjatë vitit kalendarik 2018 nga

Federata e Gjmnastikës. Ndërsa në konkurrencën e meshkujve më të mirët u shpallën Dite Behluli (Fatos), Taulant Ramadani (Pionier), Elion Vitia (Juniorë), Ardi Halili (Senior).



'IHF Trophy Intercontinental' organizohet në Kosovë

PRISHTINË, 18 SHKURT - Federata e Hendbollit e Kosovës (FHK) ka arritur sukses të jashtëzakonshëm duke marrë të drejtën e organizimit të garës prestigjioze "IHF Trophy Intercontinental". Ky vendim ka ardhur pas një takimi që drejtuesit e Federatës së Hendbollit të Kosovës (FHK) e patën të hënën me presidentin e Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit (IHF), Hassan Moustafa. Në Prishtinë nga data 9 deri më 15 prill do të mbahet faza interkontinentale e IHF Trophy për hendbollistët deri 19 vjet dhe për ata deri në 21 vjet. "Ky sukses shumë i madh vjen pas organizimit të shkëlqyeshëm të IHF Trophy për



Evropë (U-18, U-20) që u mbajt në Prishtinë muaj më parë. Të gjitha kombëtares pjesëmarrëse, por edhe zyrtarët e IHF-së, e vlerësuan organizimin si shumë të mirë. Edhe vetë presidenti Moustafa ka lavdëruar FHK-në për atë organizim. Dhe kështu Kosovës i është besuar edhe

organizimi i garës 'IHF Trophy' në nivel Interkontinental", thuhet në njoftimin e FHK-së.

Tash Kosovës U21 i hapen rrugët për të marrë pjesë në botërorin U21 për hendbollistë që mbahet nga data 14-29 korrik 2019 në Spanjë. Fituesi i "IHF Trophy Intercontinental" në grupmshën U21 kualifikohet për në Botëror. Federata e Hendbollit të Kosovës mori përkrahje nga IHF-ja për shkollim të trajnerëve e të gjyqtarëve, ndërsa përkrahja nuk do të mungojë as në pajisje të ndryshme të hendbollit. IHF-ja do të përkrahë FHK-në edhe për përmirësim të infrastrukturës dhe në aspekte të tjera me rëndësi.

Sonte finalja e parakohshme Liverpool - Bayern

LIVERPOOL, 18 SHKURT (ER) - Nënkampionia e Evropës, Liverpool, sonte (e martë) në "Anfield" e pret skuadrën e Bayern Munchenit, në kuadër të ndeshjes së parë të 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve. Skuadra e Jurgen Kloppit është aktualisht e dyta në Premierë Ligë, por një ndeshje më pak të zhvilluar dhe pikë të barabarta me Manchester Cityn. Trajneri gjerman Klopp në lidhje me përballjen ndaj Bayernit ka thënë se në këtë ndeshje "Reds" për fitore duhet ta japë maksimumin. "Nëse duam të kemi një shans ta mposhtim Bayernin duhet të japim 100%. Në të kundërt, nuk kemi asnjë mundësi. Bayerni jashtë forme? Kësaj i thonë të ankoresh në nivelin më të lartë", ka thënë Kloppi. Ndërsa për Liverpoolin në këtë ndeshje mund të paraqitet edhe futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri që në të kaluarën ka bërë karrierë edhe në Bayern. Futbollisti shqiptar dëshiron që në rast të dështimit të Liverpoolit në Ligën e



Kampionëve, këtë garë ta fitojë skuadra gjermane. "Kam kujtime të bukura nga koha ime në Munchen. Periudha më e mirë e karrierës sime ishte me Bayernin. Mësova shumë dhe bëra shumë miq. Sa herë kthehem në Munchen ndihem si në shtëpi. Rikthimi një ditë do të ishte i mundur sepse Bayerni është gjithmonë në zemrën time", ka thënë Shaqiri, duke shtuar: "A do të festoj nëse shënoj nesër? Nuk mund ta them me siguri. Do të jetë një vendim spontan. Por di të them se do ta kem të vështirë të festoj ndaj Bayernit. Dua që Liverpooli ta fitojë

Ligën e Kampionëve, por nëse nuk ia dalim, do të doja që Bayerni të shpallej kampion". Për ndeshjen ndaj Liverpoolit foli edhe sulmuesi i Bayernit, Robert Lewandowski. "Çfarë mendova kur pashë shortin? Se do të jemi kundër një ekipi shumë të fortë dhe se është koha për të treguar se sa mirë jemi", ka thënë sulmuesi polak. "E di që tifozët e tyre nuk duan që ne ose unë të shënoj gol apo të fitojmë, por për mua në një atmosferë të tillë jam akoma më energjik në vërshëllimin e bilbilit për fillimin e ndeshjes. Kjo është ajo që e bën atë të veçantë për mua dhe unë jam i gëzuar për të luajtur në një stadium të tillë. Dhe nëse fitojmë, është edhe më mirë", ka deklaruar Lewandowski. Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër e 1/8 së finales në mes të Lyonit dhe Barcelonës.

SONTE TAKOHEN:
21:00 Liverpool - Bayern Munchen
21:00 Lyon - Barcelona

'All Star Game', ekipi i LeBronit fiton duelin e yjeve, Duranti shpallet MVP

NORTH CAROLINA, 18 SHKURT - Në Chalotte është luajtur ndeshja magjike e "All Star Game" në NBA, ku përballë njëri-tjetrit ishin ekipet e LeBron Jamesit dhe Giannis Antetokounmpo. Ekipi i LeBronit fitoi 178-164 (37-53, 45-42, 50-36, 46-33). Një ndeshje spektakolare në mes të basketbollistëve më të mirë në NBA, që konfirmuan edhe një herë se jo më kot janë përzgjedhur në këtë sfidë magjike. Kevin Durant, me 31 pikë, u shpall MVP i këtij takimi, pasi ishte shënuesi më i mirë i skuadrës fituese.



Ndërkohë që, basketbollisti që realizoi më shumë ishte Antetokounmpo, 38 pikë, por ishte pjesë e ekipit humbës. Ndeshja nisi mirë për skuadrën e Giannisit, ku luante edhe Stephen

Curry (17 pikë), por në pjesën e dytë vjen rikuperimi i ekipit të LeBronit, që e meritoi fitoren. Në ekipin e LeBron (19 pikë), përveç Durant që u zgjodh MVP, kishte më shumë basketbollistë "big", si James Hardeni (12 pikë), Kyrie Irvingu (13 pikë) apo Kawhi Leonard (19 pikë). Një ndeshje spektakolare për sa iu përket guajtjeve nga distanca. Në këtë sfidë magjike morën pjesë edhe dy veteranë të NBA-së, si Dirk Nowitzki e Dwayne Wade, që në fund të sfidës u nderuan nga organizatorët.

SHKURT

Orlando transferon Nanin

Luis Nani bëhet gati për të nisur një aventurë të re përtej Oqeanit. Sulmuesi i Sporting Lisbonës do ta vazhdojë karrierën në Major League Soccer me ekipin e Orlando Cityt, që ka vendosur të bëjë një goditje të madhe, e para që pas largimit të Kakasë. Nani do të përfitojë rreth katër milionë euro në vit për dy sezona me ekipin amerikan, ndërsa tashmë ka zbarkuar në Florida për t'iu nënshtruar vizitave mjekësore me klubin e ri. Nani ka pasur një karrierë shumë të suksesshme në Evropë, sidomos me Manchester Unitedin, skuadër me të cilën ka fituar, ndër shumë trofe, katër tituj të Premierë Ligës dhe një Ligë të Kampionëve.

Wengeri: Po më mungon futboli

Trajneri Arsene Wenger në verën e kaluar është larguar nga Arsenali. Ai ka bërë me dije se është duke shijuar në maksimum pushimin, por e pranon se është duke i munguar futboli. "Tani po e shijoj jetën dhe po udhëtoj shumë nëpër botë. Kam më pak presion, më shumë liri. Megjithatë, më mungon gara", ka thënë Wengeri.

Mourinho pranon se i pëlqen të punojë në Francë

Trajneri Jose Mourinho ka drejtuar klube në Spanjë, Itali, Angli e Portugali, por e ka konfirmuar se të punuarit në një ligë tjetër do të ishte "përvojë fantastike" dhe pranon se Liga 1 e Francës është në planet e tij. "Unë jam një njeri i cili ka punuar në katër shtete të ndryshme. Unë dëshiroj të njoh kulturën e tjerë. Të punuarit në një kampionat të ri do të ishte një përvojë fantastike. Unë mund ta imagjinoj veten si një trajner në Ligën 1", ka thënë Mourinho.

Wanda Nara: Interi, familja jonë, nuk duam të largohemi

Wanda Nara foli për herë të parë në lidhje me heqjen e shiritit të kapitenit të Mauro Icardit nga drejtuesit e klubit të Interit. Bashkëshortja dhe njëkohësisht agentja e lojtarit u përlot gjatë emisionit, ku deklaroi se nuk kishte marrë asnjë paralajmërim për këtë vendim të klubit dhe se familja e saj është e gjitha interiste dhe, si e tillë, nuk ka i shkuar ndërmend të largohet nga Milano. "Disa njerëz thonë se shiriti i kapitenit i pakuptimtë, por për Mauro Icardin ishte si ta hiqnin njërin këmbë sesa thjesht krahen. Ai vesh fanellën me kaç shumë krenari dhe nëse do të ishte nevoja, në të shkuarën për të zgjedhur midis parave dhe fanellës, ai do ta zgjidhte gjithmonë fanellën. Nuk më dhanë asnjë paralajmërim. Jam gjithmonë në kontakt me klubin, por e mora vesh lajmin për heqjen e shiritit të kapitenit nga një postim i klubit në rrjetet sociale. Kam pasur pak më parë një takim që zgjati tre orë për drejtuesit, por s'ma përmendën kurrë këtë", ka thënë Wanda Nara. "Mauro ka shënuar 120 gola me këtë fanellë dhe kur askush nuk ishte më besim, ai ishte i pari që merrte topin dhe çonte skuadrën përpara, pasi ai beson te kjo skuadër. Mbetemi një familje interistësh, s'ka rëndësi nëse ai është në fushë ose jo. Interi është familja ime. Kur ndodhi incidenti, kur ma goditën makinën me gurë, të parët që mora në telefon ishin njerëzit e klubit. Icardi në atë çast ndodhej në gjumë, pasi ishte stërvitur pasdite. Nuk kemi në plane të largohemi", ka deklaruar Wanda Nara.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

American
Taste

**SINCE
1905**





Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave duke u bazuar në Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 22 paragrafi 3, vazhdon afatin e konkursit të shpallur më datë **04.02.2019** edhe për shtatë (7) ditë tjera kalendarike, për shkak se nuk është arritur pranimi i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik dhe gjinor, për pozitën :

Zyrtar Ligjor (1 pozitë)

Kushtet e vendin e punës mbeten të njëjta si në konkursin e mëparshëm. Kandidatët që kanë aplikuar në afatin e parë të konkursit për pozitën e përmendur nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

Departamenti i Administratës / ARH

OBAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Regulativni Autoritet Železnica, na osnovu Pravilnika br.02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi član 22 stav 3, produžava rok konkursa objavljeno datuma **04.02.2019** za jos 7 (sedam) drugih kalendarskih dana, sa obzirom da nije postignut balansirani prijem broja aplikacija iz etničkog i pol aspekta, za pozicije :

Pravni službenik 2 (1 pozicije)

Uslovi za položaj ostaju isti kao u prethodnom konkursu. Kandidati koji su se prethodno prijavili za poziciju navedenog oglasa, ne moraju da se ponovo prijave.

Odeljenja za Administraciju / RAŽ

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax: +381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Filloreta (Nuhi) Shala shpall të pavlefshme dipolomën e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore, Departamenti: Biologji, drejtimi : Aplikativ, Studimet themelore (Bachelor).

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense



BËHU REKRUT I FSK-së!

BËHU USHTAR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

KONKURS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës shpall konkurs për pranimin e rekrutëve të rinj – ushtarë aktivë për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës 11 deri më 22 shkurt 2019.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në të gjitha kazernat e FSK-së, si dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, www.mksf-rks.org, apo www.rks-gov.net/mfsk.

Ministria e Mbrojtjes ju shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e të rinjve pa dallim nga përkatësia e tyre etnike, gjinore dhe racore.



Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht në të gjitha kazernat e FSK-së,
çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355.